

“SINJALIZIM PUBLIK” PËR MOS ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE



(ANALIZË E ZBATIMIT TË LIGJIT PËR
MBROJTJEN E SINJALIZUESVE
NGA INSTITUCIONET PUBLIKE)

Autorët: Gzim Shala dhe Lavdim Bajraktari

Ekipi redaktues: Betim Musliu, Ehat Miftaraj dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Prill 2020

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1.	Përmbledhje ekzekutive	5
2.	Metodologjia	7
3.	Baza ligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve në Kosovë	9
4.	Obligimet ligjore të institucioneve publike sipas LMS-së	10
4.1.	Draftimi dhe Miratimi i Rregullores për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit	11
4.2.	Afati ligjor për zbatimin e këtyre obligimeve ligjore.....	12
4.3.	Kundërvajtjet sipas LMS-së.....	13
5.	Zbatimi i obligimeve ligjore sipas LMS-së nga institucionet publike	14
5.1.	Caktimi i zyrtarëve përgjegjës nga ana e institucioneve publike	15
5.1.1.	(Mos) respektimi i afatit ligjor për caktimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim	18
5.2.	Njoftimi me shkrim i të punësuarve mbi procedurat për sinjalizim.....	22
5.2.1.	(Mos) respektimi i afatit ligjor për caktimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim	23
6.	Rastet e sinjalizimit të brendshëm të paraqitura në institucionet publike	25
7.	Kundërvajtjet e institucioneve publike sipas LMS-së , të identifikuar nga IKD.....	26
8.	ANEX – Zbatimi i obligimeve të dala nga LMS, nga secili institucion publik	32
8.1.	Pushteti ekzekutiv	33
8.2.	Pushteti lokal.....	36
8.3.	Sistemi i drejtësisë	39
8.4.	Agjencitë e pavarura	42
8.5.	Ndërmarrjet Publike.....	45
8.6.	Institucionet tjera.....	48
9.	Konkluzionet.....	51
10.	Rekomandimet	54

Shkurtesat

LMI	Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve
LMS	Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve
AKK	Agjencia Kundër Korrupsion
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
MD	Ministria e Drejtësisë
LPKIUFP	Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik
Udhëzuesi	Udhëzuesi për Mbrojtjen e Sinjalizuesve
ZPK	Zyra e Presidentit të Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSh	Ministria e Shëndetësisë
MZhR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
SHSKUK	Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës
KMDM	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë

1. Përmbledhje ekzekutive

Në Republikën e Kosovës prej 2 janarit 2019 ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (LMS), i cili ka përcaktuar rregullat, procedurat e sinjalizimit, të drejtat dhe mbrojtjen e sinjalizuesve si dhe detyrimet e institucioneve publike dhe subjekteve private në lidhje me sinjalizimin. LMS ka përcaktuar ndërtimin e një sistemi të sinjalizimit, e që për konsolidimin e këtij sistemi, i njëjti ligj ka përcaktuar obligime ligjore konkrete për të gjitha institucionet publike dhe private. Në këtë drejtim, LMS ka përcaktuar se secili institucion publik, ndër të tjera, ka për obligim ligjor që brenda afatit prej gjashtë (6) muajve të caktojë zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit si dhe të njoftojë me shkrim të gjithë të punësuarit lidhur me procedurat e sinjalizimit dhe të drejtat e parapara me LMS. Mos zbatimi i këtyre obligimeve ligjore brenda afatit ligjor, sipas LMS-së sanksionohet si kundërvajtje, të cilën procedurë, AKK obligohet që ta iniciojë me së largu brenda gjashtë (6) muajve.

IKD në këtë raport ka monitoruar dhe hulumtuar zbatimin dhe mos zbatimin e obligimeve ligjore të LMS-së nga ana e institucioneve publike. Në këtë drejtim, lidhur me përmbushjen e këtyre obligimeve ligjore dhe respektimit të afateve ligjore, IKD u është drejtuar me kërkesa për informata dhe qasje në dokumente publike, 137 institucioneve publike.

Gjetjet e IKD-së tregojnë se jo të gjitha institucionet publike e kanë të qartë LMS-në, mënyrën dhe procedurën e funksionimit të tij si dhe obligimet që këto institucione kanë përballë këtij ligji. Për më tepër, vërehen disa mos kuptime elementare, siç është dallimi në mes zyrtarit përgjegjës për rastet e sinjalizimit dhe sinjalizuesve apo faktit se emri i zyrtarit përgjegjës duhet të dihet nga të punësuarit etj. Kësaj paqartësie të institucioneve publike i ka kontribuar edhe mungesa e legjislacionit sekondar. Nisur nga fakti se LMS është ende në fazën e konsolidimit, mungesa e njohurive lidhur me fushën e sinjalizimit nga ana e institucioneve publike paraqet sfida serioze në zbatimin e LMS-së, veçanërisht në rastet kur në institucionet publike paraqiten raste konkrete të sinjalizimit të brendshëm.

Në një rast, një institucion publik zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit, në mungesë të njohurive mbi LMS-në, e kishte mbajtur të fshehur për punëtorët e tjerë, përkatësisht për personat që potencialisht mund të paraqiten si sinjalizues. Arsyetimi për këtë veprim kishte qenë qëllimi i institucionit publik që zyrtari përgjegjës për rastet e sinjalizimit “*të jetë i suksesshëm në punë*”. Ndërsa, në dy (2) përgjigje të pranuar nga IKD, institucionet publike zyrtarit përgjegjës për rastet e sinjalizimit i referohen si “*sinjalizues*”.

Në anën tjetër, nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur në kërkesat e IKD-së, të paktën njëra nga to nuk ka caktuar fare zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit, derisa në caktimin e zyrtarëve përgjegjës për rastet e sinjalizuesve, 23 institucione kanë shkelur afatin ligjor prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të LMS-së. Lidhur me caktimin e zyrtarëve përgjegjës për rastet e sinjalizimit, në të paktën shtatë (7) raste, institucionet publike kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit vetëm pasi IKD ka dërguar kërkesë për informata dhe qasje në dokumente publike në institucionet respektive.

Nisur nga fakti se zyrtari përgjegjës për rastet e sinjalizimit caktohet thjesht me nxjerrjen e një vendimi nga punëdhënësi, IKD vlerëson se shkelja e afatit ligjor në këtë rast paraqet mos seriozitet të këtyre institucioneve publike përballë LMS-së.

Në anën tjetër, nga të gjitha institucionet që kanë kthyer përgjigje, 51 prej tyre kanë njoftuar se u kanë siguruar të punësuarve udhëzime me shkrim lidhur me procedurat e sinjalizimit. Katër (4), institucione publike nuk i kanë njoftuar fare të punësuarit e tyre lidhur me të drejtat që dalin nga LMS. Ndërsa, 17 institucione të tjera nuk e kishin respektuar formën e dhënies së udhëzimeve për të punësuarit, në atë mënyrë që tetë (8) institucione publike kanë deklaruar se udhëzimet i kanë dhënë gojarisht, derisa nëntë (9) të tjera këtë obligim ligjor “e kanë përmbushur” me anë të publikimit të Udhëzuesit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në faqet e tyre zyrtare. Ndërsa, të paktën gjashtë (6) institucione publike, njoftimin me shkrim për të punësuarit lidhur me procedurat e sinjalizimit e kishin bërë vetëm pasi IKD kishte dërguar kërkesë për informata dhe qasje në dokumente publike në institucionet respektive.

Lidhur me shkeljet e obligimeve ligjore sipas LMS-së, në këtë raport IKD ka evidentuar se në total, institucionet publike kanë kryer gjithsej 61 kundërvajtje, të cilat janë të listuara në një tabelë të veçantë.

Për më tepër, nga të gjitha përgjigjet e pranuar, IKD ka gjetur se në të gjitha institucionet publike, si sinjalizim i brendshëm ka qenë vetëm një (1) rast, derisa AKK ka konfirmuar se ka qenë edhe një rast tjetër i sinjalizimit të brendshëm, si dhe pesë (5) raste të sinjalizimit të jashtëm.

Mbi bazën e këtyre gjetjeve, IKD vlerëson se edhe pasi ka kaluar mbi një (1) viti që nga hyrja në fuqi e LMS-së, sistemi i sinjalizimit i përcaktuar nga LMS ende nuk ka arritur të konsolidohet. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të mos njohurive të institucioneve publike mbi LMS-së dhe mos seriozitetin e të njëjtave për të zbatuar obligimet ligjore sipas afateve të përcaktuara.

Por, krahas këtij mos serioziteti, IKD konsideron se AKK ka bërë shmangie nga përgjegjësitë e saja ligjore si mbikëqyrëse e institucioneve publike në zbatimin e LMS-së, të cilat autorizime ligjore konsistojnë veçanërisht në mbikëqyrjen e zbatimit të obligimeve ligjore dhe inicimit të procedurave kundërvajtëse në rast të mos zbatimit, të cilin inicim, AKK nuk e ka bërë në asnjë rast.

LMS ka pasur vlerësime pozitive. Por si i vetëm, LMS nuk garanton sukses të fushës së sinjalizimit në Republikën e Kosovës, nëse i njëjti nuk zbatohet në praktikë. Për këtë arsye, për të sanuar praktikën e mos zbatimit të obligimeve ligjore nga ana e institucioneve publike, AKK duhet që menjëherë të fillojë procedurat kundërvajtëse ndaj të gjitha institucioneve që nuk kanë përmbushur këto obligime.

2. Metodologjia

IKD ka hyrë në vitin e shtatë (7) të monitorimit të sistemit të drejtësisë, përkatësisht të monitorimit të gjykatave, degëve të gjykatave, prokurorive, KGJK-së dhe KPK-së.

Krahas monitorimit të këtyre institucioneve, IKD monitoron dhe hulumton të gjitha institucionet lidhur me zbatimin e obligimeve ligjore për fusha të caktuara.

Në kuadër të “Javës Kundër Korrupsion 2019”, më 9 dhjetor 2019, “Betimi për Drejtësi” ka shfaqur dokumentarin ekskluziv nga SHBA “Sinjalizuesit e Korrupsionit”, derisa në kuadër të kësaj jave, më 10 dhjetor 2019, IKD ka publikuar raportin “Sinjalizimi dhe Mbrojtja e Sinjalizuesve (Analizë ligjore për sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve).

Me 2 janar 2019 ka hyrë në fuqi LMS, i cili ndër të tjera, përcakton një sistem të ndërtuar mirë në fushën e sinjalizimit. Me qëllim të konsolidimit të këtij sistemi, LMS ka përcaktuar obligime konkrete ligjore për të gjitha institucionet publike dhe private. Ndër të tjera, sipas LMS-së, secili institucion publik i cili ka mbi 15 të punësuar, obligohet që të caktojë zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit si dhe të njoftojë me shkrim të gjithë të punësuarit lidhur me procedurat e sinjalizimit.

Pikërisht zbatimi i këtyre obligimeve nga ana e të gjitha institucioneve publike është subjekt i hulumtimit të këtij raporti.

IKD me qëllim që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, në lidhje me zbatimin obligimeve kushtetuese dhe ligjore, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit.

Në këtë drejtim, IKD ka përpiluar forma standarde të kërkesave për qasje në informata dhe dokumente publike, të cilat duke u bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, ua ka dërguar gjithsej 137 institucioneve publike. Lidhur me këto kërkesa, IKD ka pritur institucionet publike për të dhënë përgjigje më shumë se sa afati që përcaktohet në Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike.

Kërkesat për informata dhe qasje në dokumente publike kanë përmbajtur këto pesë (5) pyetje/kërkesa: *“1. A e keni caktuar zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizuesve në institucionin e juaj?; 2. Nëse po, me cilën datë e keni caktuar zyrtarin përgjegjës dhe a mund të na e siguroni kopjen e vendimit dhe të dhënat publike lidhur me zyrtarin e caktuar?; 3. A i keni njoftuar me shkrim të gjithë të punësuarit, lidhur me të drejtat që parashihen me këtë ligj?; 4. Nëse po, me cilën datë dhe a mund të na siguroni kopjen e shkresës?; 5. Deri më tani, a është paraqitur ndonjë rast i sinjalizimit në institucionin tuaj?”.*

Pas pranimit të përgjigjeve nga ana e institucioneve publike, IKD ka përpunuar këto informata, duke dhënë përmbledhje të përgjithshme dhe të veçanta mbi zbatimin dhe mos zbatimin e obligimeve sipas LMS-së nga ana e institucioneve publike. Në këtë rast, IKD ka bërë një analizë të thellë dhe të detajuar të secilës përgjigje të pranuar, nëse është zbatuar drejt LMS,

me ç'rast ka analizuar formën e zbatimit të obligimeve ligjore, afatin ligjor të zbatimit të këtyre obligimeve etj.

Pasqyrimi i gjetjeve në raport nga ky hulumtim është bërë me një mënyrë të thjeshtëzuar, duke dhënë pasqyrim të zbatimit të obligimeve të LMS-së nga ana e institucioneve publike në përgjithësi, por edhe si të ndara për sektorë të ndryshëm të institucioneve publike.

Pas identifikimit dhe analizimit të gjetjeve dhe çështjeve problematike karshi ligjit, standardeve dhe praktikave ndërkombëtare, IKD ka zhvilluar intervista të thella me të gjithë hisedarët e bërjes së politikave dhe ligjeve për fushën e sinjalizimit dhe zbatuesit e LMS-së. Intervistat janë zhvilluar në bazë të indikatorëve të vendosur si rezultat i hulumtimit, gjetjeve dhe vlerësimeve nga ana e analistëve juridikë të IKD-së, të cilat kanë shërbyer për të nxjerrë në pah problemet reale në fushën e zbatimit të LMS-së nga ana e institucioneve publike. Intervistat e zhvilluara janë kodifikuar ashtu që çështjet dhe informatat e dala nga to janë përfshirë në raport.

3. Baza ligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve në Kosovë

Për herë të parë në Kosovë, çështja e sinjalizuesve ishte rregulluar në vitin 2011, në të cilin vit, ishte miratuar Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve. Ky ligj ishte miratuar për siç thuhej, krijimin e një baze ligjore që do të inkurajonte zyrtarët për paraqitjen e veprimeve kundërligjore.

Me këtë ligj, me termin informator, përkufizohej *“çdo person, i cili si qytetar apo i punësuar, informon në mirëbesim autoritetin përkatës brenda institucioneve publike në nivelin qendror apo lokal, institucione, ndërmarrje publike apo private për çdo dyshim të arsyeshëm për ekzistimin e veprimit kundërligjor”*¹.

Ky ligj kishte pasur gjithsej 11 nene dhe përcaktonte parimet themelore në fushën e informatorëve, përgjegjësinë e institucioneve, vendosjen për veprimin e kundërligjshëm dhe disa aspekte të tjera procedurale dhe teknike.

Por në esencë, ky ligj nuk ndërtonte një sistem të raportimit dhe mbrojtjes së raportuesve, të cilëve ligji në fjalë u referohej si informatorë. Për më tepër, veprimi kundërligjor, raportimi i të cilit mbrohej me këtë ligj, kufizohej vetëm në veprimin apo mosveprimin e personit me të cilat cenohen dispozitat në fuqi, qoftë në formë të veprës penale apo kundërvajtjes.²

Ky ligj ka qenë në fuqi deri më 2 janar 2019, kur edhe ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (LMS).³

Me ligjin e ri, përveç se kësaj kategorie i jepet një emërtim më adekuat, konkretisht emërtimi “sinjalizues” e jo “informatorë”, siç ishin quajtur në ligjin e vjetër, po ashtu, një rëndësi e madhe i është kushtuar edhe sektorit privat krahas atij publik. Në këtë rast, dispozitat të cilat kanë të bëjnë me sinjalizimin nga sektori privat kanë hyrë në fuqi më 2 janar 2020.⁴

Me emërtimin sinjalizues, sipas përkufizimit që jep vet LMS-ja, nënkuptohet *“çdo person i cili raporton ose shpalos informacione për një kërcënim ose cenim të interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së vet të punës në sektorin publik ose privat”*.⁵

Me LMS-në, janë përcaktuar rregullat për sinjalizimin, procedurat e sinjalizimit, të drejtat dhe mbrojtja e sinjalizuesve dhe detyrimet e institucioneve publike dhe subjekteve private në lidhje me sinjalizimin.

Sipas LMS-së, llojet e sinjalizimit mund të jenë, i brendshëm, i jashtëm dhe publik. Sipas ligjit, raportimi i informacionit të punëdhënësi konsiderohet si sinjalizim i brendshëm, raportimi i

¹ Ligji Nr.04/L-043 për Mbrojtjen e Informatorëve, neni 2, par1, nënpar1.1.

² Shala G. *“Sinjalizimi dhe Mbrojtja e Sinjalizuesve”*. IKD. Dhjetor 2019. (Shih linkun: <https://kllks.org/sinjalizimi-dhe-mbrojtja-e-sinjalizuesve-analize-ligjore-per-sinjalizuesit-dhe-mbrojtjen-e-sinjalizuesve/>)

Qasur së fundi 23 shkurt 2020.

³ Ligji Nr. 06/L -085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

⁴ Ligji Nr. 06/L -085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, neni 32.

⁵ Ligji Nr. 06/L -085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, neni 3, par1 nënpar1.1.

informacionit tek autoriteti kompetent konsiderohet si sinjalizim i jashtëm ndërsa shpalosja e informacionit në media, tek organizatat joqeveritare, përmes internetit, në një mbledhje publike, ose në ndonjë mënyrë tjetër që e bën informacionin publik konsiderohet si sinjalizim publik.⁶

Ligji ka paraparë edhe rastet e sinjalizimit kur këto të fundit lidhen edhe me sigurinë kombëtare, mbrojtjen, inteligjencën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Për këtë lloj sinjalizimi, LMS ka paraparë që sinjalizuesi të paraqet rastin organit kompetent në këto fusha.⁷

4. Obligimet ligjore të institucioneve publike sipas LMS-së⁸

Me anë të procedurave dhe llojeve të sinjalizimit, LMS ka paraparë zhvillimin e një sistemi të konsoliduar të sinjalizimit, me qëllim të ruajtjes së interesit publik dhe mbrojtjes së sinjalizuesve.

Nisur nga fakti se sinjalizues potencial paraqiten në secilin institucion, LMS ka përcaktuar obligime konkrete ligjore për secilin institucion publik dhe privat, mos zbatimi i të cilave sipas LMS-së paraqitet si kundërvajtje.

Te obligimet e punëdhënësve, krahas të tjerave, LMS ka paraparë që secili punëdhënës publik i cili ka më shumë se pesëmbëdhjetë (15) të punësuar dhe punëdhënësi privat, i cili ka më shumë se pesëdhjetë (50) të punësuar, janë të obliguar të caktojnë zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit.⁹

LMS ka lënë hapësirë që sinjalizuesit potencial t'i drejtohen drejtpërdrejt punëdhënësit në rast se kur ky i fundit nuk ka caktuar zyrtar përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizuesve apo nuk ka përcaktuar dhe publikuar procedura të brendshme për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimeve.

Sipas LMS-së, Qeveria, sipas propozimit të Ministrisë së Drejtësisë është obliguar që me akt nënligjor përcakton procedurën për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, ndërsa subjektet private janë obliguar që të përcaktojnë procedurën për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit me akt të brendshëm në pajtim me këtë ligj.¹⁰ Ky obligim ende nuk është përmbyshur.

Po ashtu, ndër obligimet tjera që ka përcaktuar LMS, është edhe obligimi i punëdhënësit i paraparë në paragrafin 1 të nenit 28 të LMS-së, që t'iu sigurojë të punësuarve udhëzime **me**

⁶ Ligji Nr. 06/L -085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, neni 13.

⁷ Ligji Nr. 06/L -085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, neni 21.

⁸ Shënim: Në këtë pjesë janë pasqyruar vetëm obligimet ligjore të institucioneve, të cilat obligime janë trajtuar në këtë raport. Për më shumë, shih Shala G. "Sinjalizimi dhe Mbrojtja e Sinjalizuesve". IKD. Dhjetor 2019. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/sinjalizimi-dhe-mbrojtja-e-sinjalizuesve-analize-ligjore-per-sinjalizuesit-dhe-mbrojtjen-e-sinjalizuesve/>) Qasur së fundi 23 shkurt 2020.

⁹ Ligji Nr. 06/L -085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, neni 17.

¹⁰ Po aty, neni 5.

shkrim lidhur me procedurat për sinjalizimin. Sipas LMS-së, udhëzimet nga paragrafi 1 i këtij neni si dhe çdo informacion tjetër i dobishëm lidhur me sinjalizimin publikohen dhe përditësohen rregullisht dhe shpërndahen përshtatshëm në mjediset e punëdhënësit dhe në faqe të internetit kur është e mundur teknikisht.

4.1. Draftimi dhe Miratimi i Rregullores për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit

Neni 17 i LMS-së përcakton obligimin ligjor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratuar aktin nënligjor që përcakton procedurën për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizuesve. Bazuar në nenin 30.1 të LMS-së, këtë obligim Qeveria e Republikës së Kosovës ka qenë e obliguar ta përmbushë deri me 2 korrik 2019.

Qeveria Haradinaj kishte dështuar që ta përmbushë këtë obligim ligjor. Dorëheqja e Kryeministrit Haradinaj nuk ndërlidhet me këtë dështim, pasi përderisa afati i fundit për miratimin e kësaj rregulloreje ka qenë 2 korrik 2019, Haradinaj kishte dhënë dorëheqje me 19 korrik 2019. Pra, kemi pasur mungesë të efikasitetit, dhe jo probleme politike.

Por, Ministria e Drejtësisë veç se ka proceduar me draftimin e draftit preliminar të Rregullores për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizuesve, derisa ky draft ende është duke u trajtuar nga kjo Ministri.

Lidhur me draft-rregulloren, fillimisht, IKD konsideron se kjo draft-rregullore duhet të përmbushë parimin e sigurisë juridike në kuptim të qartësisë së dispozitave, si dhe të kufizohet në materien për të cilën ligji kërkon miratimin e këtij akti nënligjor. Pra, MD duhet të ketë kujdes që para së gjithash, rregullorja të jetë në përputhje të plotë me sistemin e sinjalizimit, tanimë të ndërtuar me LMS.

Në këtë drejtim, IKD i bënë thirrje Ministrisë së Drejtësisë që ta ketë parasysh qëllimin e kësaj rregulloreje, e që është kompletimi i infrastrukturës ligjore për fushën e sinjalizimit në Republikën e Kosovës.

Në këtë drejtim, problemet me informimin e institucioneve përkitazi me LMS-në duhet të trajtohen me udhëzues, takime, trajnime etj. por jo që vetë akti nënligjor të ketë karakter të udhëzuesit, për çështjet tanimë të rregulluara detajisht me LMS.

Tutje, janë një sërë çështjesh të cilat IKD vlerëson se duhet të rregullohen me anë të kësaj rregulloreje, e cila mungesë e rregullimit, nga hulumtimi i IKD-së ka rezultuar se paraqet probleme në zbatimin praktik të LMS-së.

Në këtë drejtim, kjo rregullore duhet ta rregullojë në mënyrë të detajuar dhe deri në detajet teknike raportin e institucioneve publike me AKK-në. Kjo me qëllim të kësaj agjencie ti mundësohet monitorimi efikas i zbatimit të LMS-së.

Po ashtu, IKD konsiderohen se me këtë rregullore duhet të përcaktohet edhe fakti që secili institucion publik obligohet që emrin e zyrtarit përgjegjës ta bëjë publik në faqen e saj zyrtare.

Sa i përket zyrtarit përgjegjës, janë disa çështje me rëndësi që IKD konsideron se kjo rregullore duhet t'i adresoj.

Fillimisht, me qëllim të fuqizimit të bazës juridike, kjo rregullore duhet të përcaktoj se zyrtari përgjegjës caktohet me vendim nga ana e drejtuesit të institucionit. Kjo për arsye se në praktikë kemi parë se disa institucione nuk kanë nxjerrë fare vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës, por vetëm e kanë njoftuar AKK-në për caktimin e të njëjtit, i cili njoftim nuk ka pothuajse fare fuqi juridike, madje as brenda vet institucionit.

Çështje tjetër që ndërlidhet me zyrtarin përgjegjës janë edhe kriteret që institucioni publik t'i marrë parasysh me rastin e caktimit të zyrtarit përgjegjës, të cilat kriteret duhet të përcaktohen me këtë rregullore, përfshi integritetin e zyrtarit, profesionalizmin dhe paanshmërinë politike.

Çështja pasuese sa i përket zyrtarit përgjegjës që duhet të trajtohet nga kjo rregullore është mandati i zyrtarit përgjegjës, pjesë e cila nuk rregullohet nga LMS.

Çështja e kushteve të punës se zyrtarit përgjegjës duhet të trajtohet nga kjo rregullore në mënyrë të përshtatshme.

Sa i përket zyrtarit përgjegjës, kjo rregullore duhet të rregullojë edhe situatën nëse zyrtari përgjegjës jep dorëheqje, apo për arsye të tjera, kjo pozitë mbetet e lirë. Krahas të tjerave, në këtë pjesë duhet të trajtohet edhe afati i institucionit publik për të caktuar zyrtarin e ri përgjegjës, pas dorëheqjes së zyrtarit përgjegjës paraprak.

Dhe e fundit sa i përket zyrtarit përgjegjës, IKD konsideron se kjo rregullore duhet të rregullojë edhe situatën nëse në një institucion publik, asnjë prej zyrtarëve nuk pranon që të caktohet zyrtar përgjegjës, e cila situatë potencialisht ka mundësi ta sfidojë zbatimin e LMS-së në të ardhmen.

4.2. Afati ligjor për zbatimin e këtyre obligimeve ligjore

Neni 32 i LMS-së ka përcaktuar se *“Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa dispozitat që i referohen sektorit privat fillojnë të zbatohen një (1) vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji”*.

LMS është publikuar në gazetën zyrtare më 18 dhjetor 2018. Në këtë mënyrë, LMS ka hyrë në fuqi më 2 janar 2019, derisa dispozitat që i referohen sektorit privat kanë filluar të zbatohen më 2 janar 2020.

Ndërsa, paragrafi 1 dhe 2 i nenit 30 të LMS-së përcaktojnë se *“Aktet nënligjore për zbatim të këtij ligji, do të nxirren brenda **gjashtë (6) muajve** prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në afat prej **gjashtë (6) muajsh** pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, punëdhënësit sipas këtij ligji*

caktojnë zyrtarët përgjegjës për sinjalizim dhe e njoftojnë AKK-në për sektorin publik, përkatësisht Inspektoratin e Punës për sektorin privat”.

Në këtë mënyrë, sa i përket akteve nënligjore, afati i fundit për nxjerrjen e të njëjtave ka qenë data 2 korrik 2019.

Po ashtu, edhe sa i përket caktimit të zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim në institucionet publike, afati ligjor ka qenë deri më 2 korrik 2019, derisa për sektorin privat, ky afat ligjor skadon me 2 korrik 2020.

Po ashtu, në kuptim të nenit 27.1.1.2 dhe nenit 30.3 të LMS-së, afati i fundit i institucioneve publike për të njoftuar me shkrim të punësuarit mbi procedurat e sinjalizimit ka qenë deri më 2 korrik 2019.

4.3.Kundërvajtjet sipas LMS-së

Paragrafi 3 i nenit 30 të LMS-s ka përcaktuar se *“Agjencia kundër Korrupsionit dhe Inspektorati i Punës, obligohen të fillojnë procedurat sipas ligjit për kundërvajtje ndaj punëdhënësve dhe zyrtarëve përgjegjës të cilët nuk i kane përmbushur obligimet sipas këtij ligji, jo më vonë se gjashtë (6) muaj”.*

Nëse i referohemi faktit se caktimi i zyrtarëve përgjegjës në institucionet publike si dhe njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS, ka qenë obligim që duhet të përmbushet më së voni deri më 2 korrik 2019, atëherë i bie se AKK është dashur që procedurat potenciale t'i filloj më së largu deri më 2 janar 2020.

Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 27 përcakton se “Gjykata kompetente shqipton gjobë prej pesëqind (500) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro për institucionin publik apo subjektin privat si dhe autoritetin kompetent përkatës, në rast se: 1.1. nuk mbron sinjalizuesin nga ndonjë veprim i dëmshëm ose nuk ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për ndërprerjen e veprimit të dëmshëm, si dhe eliminimin e çdo pasoje të veprimit të dëmshëm, brenda kompetencave të veta;1.2. **nuk njofton me shkrim të gjithë të punësuarit, lidhur me të drejtat që parashihen me këtë ligj**;1.3. **nuk cakton zyrtarin përgjegjës**;1.4. nuk ndërmerr veprime pas raportimit të informacionit brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj;1.5. nuk informon sinjalizuesit për rezultatin e procedurës, brenda afatit të përcaktuar; 1.6. nuk informon sinjalizuesit, sipas kërkesës së tij, lidhur me ecurinë dhe veprimet e ndërmarra në procedurë, ose nuk i mundëson sinjalizuesit që të ketë qasje në shkresat e lëndës dhe që të marrë pjesë në veprimet e ndërmarra gjatë procedurës së sinjalizimit.1.7. në rast se pengon sinjalizimin, siç përcaktohet me neni 6 të këtij ligj;1.8. në rast se vepron në kundërshtim me nenin 11 të këtij ligji”.

Sipas paragrafit 4 të nenit 27 të LMS-së, “Zyrtari përgjegjës i institucionit publik, subjektit privat si dhe i autoritetit kompetent përkatës dënohet me gjobë prej treqind (300) euro deri në dymijë (2.000) euro në rastet kur është përgjegjës sipas nën paragrafëve 1.1, 1.2 dhe 1.4 deri në 1.6 të paragrafit 1 të këtij neni”, derisa inicimi i procedurës kundërvajtëse për sektorin publik

bëhet nga AKK, respektivisht nga Inspektorati i Punës për sektorin privat.¹¹ Por, “nëse brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve institucionet përgjegjëse nuk ndërmarrin asnjë veprim apo refuzojnë të veprojnë atëherë sinjalizuesi mund të iniciojë vetë procedurën”¹².

5. Zbatimi i obligimeve ligjore sipas LMS-së nga institucionet publike

Lidhur me zbatimin obligimeve të dala nga LMS nga ana e institucioneve publike në Kosovë, IKD, gjatë periudhës kohore dhjetor 2019 – shkurt 2020, ka dërguar kërkesa për informata dhe qasje në dokumentet publike në 137 institucione publike në Kosovë.


Këto kërkesa janë dërguar duke u bazuar në Ligjin nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike i cili në paragrafin 1 të nenit 10 përcakton se “*Secili person ka të drejtë për qasje në dokumente publike në bazë të kërkesës*” derisa paragrafi 1 i nenit 12 përcakton se “*Institucioni publik detyrohet që brenda shtatë (7) ditëve prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerrë vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të nxjerrë vendim të arsyetuar për refuzimin e plotë apo të pjesshëm dhe informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për të kërkuar rishqyrtimin e kërkesës si dhe kur dhe ku të paraqitet kërkesa e tillë*”.

Nga këto kërkesa të dërguara, 87 institucione kanë kthyer përgjigje, kurse 50 institucionet nuk janë përgjigjur në kërkesat e dërguara.

Për më tepër, përderisa IKD kishte dërguar nga pesë (5) pyetje në të gjitha institucionet, disa prej institucioneve publike janë përgjigjur vetëm pjesërisht, duke mos u përgjigjur në të gjitha pyetjet dhe kërkesat e adresuara nga IKD.

¹¹ Po aty. Neni 27.3.

¹² Po aty. Neni 27.4.



Grafika 1 – Numri i institucioneve publike të cilat janë përgjigjur në kërkesat për informata/qasje në dokumente publike nga IKD.

Mos kthimi i përgjigjeve qoftë kjo përgjigje pozitive apo negative, nga ana 49 institucioneve publike, bie ndesh me obligimet e parapara me paragrafin 1 të nenit 10 të Ligjit nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike. Për më tepër, një mbyllje e këtij lloji nga ana e këtyre institucioneve publike paraqet mos transparencë të punës, përkatësisht shkelje të një prej parimeve bazë të punës së institucioneve publike.


Në vijim, IKD paraqet gjetjet mbi zbatimin e obligimit ligjor për caktimin e zyrtarëve përgjegjës dhe njoftimin e të punësuarve me shkrim nga ana e institucioneve publike.

5.1.Caktimi i zyrtarëve përgjegjës nga ana e institucioneve publike

Siç u tha edhe më lartë, LMS ka obliguar të gjitha institucionet publike që deri më 2 korrik 2019 të caktojnë zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizuesve, zbatimin dhe mos zbatimin e të cilit obligim ligjor e ka hulumtuar IKD.

Lidhur me këtë obligim ligjor, nga 87 institucionet publike që janë përgjigjur në kërkesat e IKD-së, 85 nga to kanë treguar që kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për të pranuar dhe trajtuar rastet e sinjalizimit.

Një institucion sipas përgjigjes për IKD, ka treguar se nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës derisa një institucion tjetër, përkundër se është përgjigjur në kërkesën e IKD-së, nuk ka treguar nëse ka caktuar apo jo zyrtarin përgjegjës për të pranuar dhe trajtuar rastet e sinjalizimit.



Grafika 2 – Numri i institucioneve që (nuk) kanë caktuar zyrtarin për trajtimin e rasteve të sinjalizimit.

Në këtë rast, IKD vlerëson se mos zbatimi i këtij obligimi ligjor nga ana e një institucioni duhet të pasohet me masa ligjore, në mënyrë që të krijohen kushte për zbatimin e LMS-së. Në të kundërtën, mos zbatimi i ligjit nga ana e një institucioni publik dhe mos ndërmarrja e masave ligjore në këtë rast paraqet shkelje të ligjit dhe shembull negativ në kuptim të ndërtimit të një sistemi të konsoliduar të sinjalizimit, siç përcaktohet me LMS.

Sipas AKK-së, zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit e kanë caktuar gjithsej 185 institucione publike. Në pyetjen se sa institucione publike nuk e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit, AKK ka deklaruar se kjo agjenci nuk posedon informacion të saktë se sa janë institucionet, të cilat sipas LMS-së janë të obliguara ta caktojnë zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit¹³.

Në anën tjetër, në media është raportuar për dyshime në paanësinë politike të personave, të cilët janë caktuar zyrtarë përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit.

Për këtë situatë, AKK ka deklaruar se zyrtarisht nuk ka pranuar asnjë ankesë ndaj ndonjë zyrtari përgjegjës, derisa për të siguruar paanësinë politike, AKK ka deklaruar se sipas LMS-së, nuk ka autorizime të tilla.

Po ashtu, sa i përket profilit profesional të zyrtarëve, të cilët nga ana e institucioneve publike janë caktuar si zyrtarë përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit, IKD ka gjetur se ka edhe profile, të cilat nuk përkojnë me detyrat që sipas LMS-së ka zyrtari përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit.

¹³ Përgjigje zyrtare e Agjencisë Kundër Korrupsionit për IKD-në dhënë përmes postës elektronike. 10 prill 2020.

Për këtë çështje, AKK thotë se LMS nuk ka përcaktuar fare kritere apo procedurë për caktimin e zyrtarëve përgjegjës për rastet e sinjalizimit, dhe se nuk ka të dhëna se çfarë kriteresh janë zbatuar dhe cila ka qenë procedura me rastin e caktimit të këtyre zyrtarëve.

Lidhur me emrat e zyrtarëve përgjegjës për rastet e sinjalizimit, të caktuar nga ana e institucioneve publike, IKD me anë të kërkesës për qasje në dokumente publike ka kërkuar nga AKK edhe listën me emrat e zyrtarëve përgjegjës për rastet e sinjalizuesve, të caktuar në institucionet publike.

Lidhur me këtë kërkesë, në përgjigjen e AKK-së thuhet:

“Agjencia nuk ka listë unike, mirëpo i disponon njoftimet, të cilat i pranojmë nga institucionet publike. Lidhur me krijimin dhe publikimin eventual, si dhe përditësimin e një liste unike duke marrë parasysh të dhënat personale, të cilat mund t’i përmbajë ajo, jemi duke vlerësuar që kjo të bëhet në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”¹⁴.

Lidhur me këtë përgjigje, IKD vlerëson se mos dhënia e qasjes në emrat e zyrtarëve përgjegjës për rastet e sinjalizuesve me arsyetimin se është duke u shqyrtuar mundësia e trajtimit të kësaj fushe sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale është e pakuptueshme dhe jo ligjore.

Fillimisht, nisur nga fakti se tanimë janë mbi 15 muaj që nga hyrja në fuqi e LMS-së, është e pakuptueshme mungesa e qëndrimit të AKK-së, nëse duhet të ipet qasje në emrat e zyrtarëve përgjegjës ose jo.

Ndërsa, në kuptim të Ligjit NR. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ky ligj ka rregulluar edhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale. Në këtë drejtim, ky ligj në nenin 3.1.1.2 ka përkufizuar përpunimin si “*çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi*”. Ndërsa, në nenin 5.1, ky ligj ka përcaktuar se “*Përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm vetëm nëse zbatohet, të paktën, njëri nga kriteret e mëposhtme:...*1.5. *nëse përpunimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ose për ushtrimin e autoritetit zyrtar që i është dhënë kontrolluesit; 1.6. nëse përpunimi është i domosdoshëm për qëllime të interesave legjitime të ushtruara nga kontrolluesi ose pala e tretë, përveç kur këto interesa tejkalohen nga interesat apo të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave që kërkon mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht nëse subjekti i të dhënave është fëmijë. Kjo nuk zbatohet për përpunimin e kryer nga autoritetet publike për përmbushjen e detyrave të tyre”.*

Në rastin e LMS-së, AKK duhet ta ketë të qartë se publiku, mediat dhe shoqëria civile janë pjesë kryesore e këtij ligji, përkatësisht sistemit apo hierarkisë së sinjalizimit. Kjo për arsye se

¹⁴ Po aty.

si shkallë e fundit e sinjalizimit, pas sinjalizimit të brendshëm dhe të jashtëm, paraqitet sinjalizimi publik.

Në anën tjetër, IKD konsideron se nisur nga fakti se secili prej zyrtarëve përgjegjës është njëherit zyrtar publik, krahas faktit se sipas LMS-së i njëjti nuk është konfidencial, dhënia qasje në emrat e këtyre zyrtarëve nuk bie ndesh me Ligjin nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për më tepër, publikimi i këtyre emrave rrit llogaridhënien e institucioneve në raport me publikun, i cili fakt ndikon që punëdhënësit në institucionet publike të veprojnë me përgjegjësi të lartë me rastin e caktimit të zyrtarëve përgjegjës.

Andaj si përfundim, për arsye si më lartë, IKD fton AKK-në që si në kërkesën e IKD-së, ashtu edhe në kërkesat e mediave dhe OJQ-ve të tjera, të jap qasje në emrat e zyrtarëve përgjegjës në institucionet publike.

5.1.1. (Mos) respektimi i afatit ligjor për caktimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim

Periudha më e hershme se kur një institucion publik ka caktuar një zyrtar përgjegjës për trajtimin e sinjalizimit, është muaji nëntor 2018, pra mbi një (1) muaj para se të hyj në fuqi LMS.

Kjo situatë ka ndodhur pasi Akademia e Drejtësisë e ka ngatërruar zyrtarin përgjegjës sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (LPKIUFP) me zyrtarin për rastet e sinjalizimit sipas LMS-së.

Në përgjigjen e Akademisë së Drejtësisë të datës 14 janar 2020 për IKD, është bashkangjitur edhe njoftimi për caktimin e zyrtarit për konflikt interesi sipas LPKIUFP. Sipas po këtij vendimi, personit të njëjtë, Akademia e Drejtësisë në përgjigje i referohet si zyrtari për rastet e sinjalizimit.

Ndërsa, lidhur me institucionet publike që e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës brenda afatit ligjor, muaji mars 2019 kishte qenë muaji kur institucionet publike kishin caktuar më së shumti zyrtarin përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit, përkatësisht, 35 institucionet e kishin përmbushur një obligim të tillë gjatë këtij muaji. Nëntë (9) institucionet tjera, zyrtarin përgjegjës e kishin caktuar në muajin prill 2019, gjashtë (6) institucionet kishin caktuarin zyrtarin përgjegjës në muajin maj 2019, gjashtë (6) institucione një gjë të tillë e kishin bërë në muajin qershor 2019 derisa një (1) institucion e ka caktuar zyrtarin përgjegjës më 2 korrik 2019, përkatësisht në ditën e fundit brenda afatit ligjor.

Ndërsa, lidhur me institucionet publike që e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës jashtë afatit ligjor, një (1) institucion e ka caktuar këtë zyrtar me 9 korrik 2019, tre (3) institucione në shtator, katër (4) institucione tjera kishin caktuar zyrtarin përgjegjës në muajin tetor, kurse, në muajin nëntor 2019, këtë zyrtar e kishin caktuar dy (2) institucione. Në dhjetor 2019, zyrtarin


përgjegjës e kishin caktuar pesë (5) institucione tjera, në muajin janar 2020, një obligim të tillë e kishin kryer edhe shtatë (7) institucione tjera, derisa këtë obligim ligjor një (1) institucion e ka përmbushur në muajin shkurt 2020.

Sipas përgjigjeve që ka pranuar IKD, katër (4) institucione publike nuk kanë treguar kohën se kur kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit.



Grafika 3 – Periudha kohore kur institucionet publike kanë caktuar zyrtarin për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit.

Pra, nga të gjitha institucionet publike prej të cilave IKD ka marrë përgjigje shihet se një (1) institucion publik “e ka caktuar” zyrtarin përgjegjës para hyrjes në fuqi të LMS-së, 57 institucione e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës brenda afatit ligjor të përcaktuar me LMS, derisa këtë afat ligjor nuk e kanë respektuar 23 institucione publike, ndërsa katër (4) institucione publike nuk kanë treguar datën e caktimit të zyrtarit përgjegjës.



Grafika 4 – Caktimi i zyrtarëve për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit sipas afatit të caktuar në LMS.

Siç shihet nga këto të dhëna, përkundër se LMS ka përcaktuar se në afat prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, punëdhënësit caktojnë zyrtarët përgjegjës për sinjalizim dhe e njoftojnë AKK-në për sektorin publik, një obligim të tillë nuk e kanë kryer gjithsej 23 institucione publike.

Për caktimin e zyrtarit përgjegjës për pranim dhe trajtim të sinjalizimit, Agjencia Kundër Korrupsion (AKK), në muajin mars 2019, kishte dërguar kërkesa tek institucionet publike për caktimin e zyrtarëve të tillë¹⁵.

Mirëpo, sipas përgjigjeve që ka pranuar IKD nga institucionet publike, të paktën një (1) institucioni nuk i kishte shkruar një kërkesë e tillë¹⁶. Për këtë arsye, ky institucion e kishte arsyetuar faktin se zyrtarin përgjegjës për sinjalizim, e kishte caktuar afër pesë (5) muaj pas afatit të përcaktuar në LMS.

Por, përkundër faktit se AKK e kishte dërguar këtë kërkesë tek të gjitha institucionet publike në muajin mars 2019, prapë janë 23 institucione publike që nuk e kanë zbatuar këtë obligim ligjor brenda afatit ligjor, krahas një institucioni tjetër që zyrtarin përgjegjës nuk e ka caktuar fare.

Për më tepër, në të paktën shtatë (7) raste, IKD ka gjetur se institucionet publike, zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit e kishin caktuar tek pas kërkesave

¹⁵ Shënim: Kjo informatë është marrë nga përgjigjet e pranuar nga një numër caktuar i institucioneve publike.

¹⁶ Shënim: Në këtë përgjigje thuhet se përpos institucionit publik që ka kthyer përgjigje, kërkesa e AKK-së nuk është dërguar edhe në një institucion tjetër.

që IKD kishte dërguar në këto institucione, ku të njëjtat ishin pyetur nëse zyrtari i tillë ishte caktuar nga ana e tyre.

Me këtë rast, IKD vlerëson se mos respektimi i këtij afati ligjor paraqet një jo seriozitet përballë obligimeve ligjore në përgjithësi, dhe përballë obligimeve që dalin nga LMS në veçanti.

Në këtë drejtim, duhet theksuar se zyrtari përgjegjës për rastet e sinjalizimit caktohet thjesht me një vendim nga ana e drejtuesit të një institucioni, derisa nxjerrja e këtij vendimi nuk kërkon zhvillimin e asnjë procedure ligjore. Në këtë mënyrë, caktimi i këtij zyrtari pas afatit ligjor nuk ka asnjë kuptim.

Për më tepër, AKK ka bërë veprim pozitiv kur ka njoftuar të gjitha institucionet publike lidhur me këtë obligim ligjor. Por, edhe pa këtë njoftim, institucionet publike duhet që ta respektojnë ligjin që i obligon pa marrë parasysh njoftimin e AKK-së.

Në këtë mënyrë, fillimisht për të respektuar ligjin por edhe për të ngritur seriozitetin në zbatimin e LMS-së, IKD vlerëson se AKK duhet menjëherë të fillojë procedurat ligjore për kryerje të kundërvajtjes nga ana e institucioneve publike.

Institucionet publike ndaj të cilave IKD konsideron se duhet të fillohet procedurë për kryerje të kundërvajtjeve për shkak të mos caktimit të zyrtarit përgjegjës brenda afatit ligjor janë të listuara në tabelën 1 të këtij raporti.

Në anën tjetër, sa i përket caktimit të zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim, vërehet një laramani edhe në mënyrën se si janë caktuar të njëjtit nga ana e institucioneve publike.

Kësisoj, 64 institucione kanë njoftuar se zyrtarët përgjegjës i kanë caktuar përmes vendimeve të nxjerra, kurse, 20 institucione, caktimin e zyrtarëve përgjegjës e kanë bërë përmes njoftimit me e-mail drejtuar AKK-së. Një (1) institucion, zyrtarin përgjegjës e kishte caktuar përmes evidentimit në procesverbal.

IKD në kërkesat për informata/qasje në dokumentet publike që u kishte drejtuar 137 institucioneve publike kishte kërkuar që në pajtim me ligjin, të ketë qasje edhe në vendimet/njoftimet për caktimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim.

Kësaj kërkesë të IKD-së, pozitivisht u janë përgjigjur 45 institucione duke lejuar qasjen në vendimet e nxjerra për caktimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim. Për këto 45 institucione, IKD ka analizuar vendimet e dërguara nga institucionet publike, për të ditur nëse ky obligim ligjor është përmbushur brenda afatit ligjor, derisa për rastet e tjera, IKD është dashur që të referohet vetëm në përgjigjen e institucionit respektiv.

Në anën tjetër, edhe vetë AKK pranon faktik se një numër i institucioneve publike nuk e kanë respektuar këtë afat ligjor, duke potencuar se kjo ka ardhur si pasojë e paqartësive ligjore dhe mungesës së udhëzimeve të qarta¹⁷.

“AKK ka pranuar dhe vazhdon të pranoj njoftime nga institucionet e sektorit publik lidhur me caktimin e zyrtarit përgjegjës. Ndërkohë, të njëjtit në disa institucione edhe janë ndërruar. Për shkak të paqartësisë ligjore (*përfshi këtu edhe mungesën e aktit nënligjor*) dhe mungesës së udhëzimeve të qarta dhe konkrete rreth caktimit të zyrtarit përgjegjës jo të gjitha institucionet kanë arritur ta bëjnë këtë brenda afatit të përcaktuar ligjor”¹⁸.

5.2.Njoftimi me shkrim i të punësuarve mbi procedurat për sinjalizim

LMS, paragrafin 1 të nenit 28, ka obliguar punëdhënësit që t’iu sigurojë të punësuarve udhëzime me shkrim lidhur me procedurat për sinjalizimin.

Po ashtu, paragrafi 2 i nenit 28 të LMS-së përcakton se “udhëzimet nga paragrafi 1 i këtij neni si dhe çdo informacion tjetër i dobishëm lidhur me sinjalizimin publikohen dhe përditësohen rregullisht dhe shpërndahen përshtatshëm në mjediset e punëdhënësit dhe në faqe të internetit kur është e mundur teknikisht”.

Lidhur me respektimin e këtij obligimi që del nga LMS, IKD ka kërkuar informata nga të gjitha institucionet publike të cilave u është drejtuar me kërkesa për informata/qasje në dokumente publike. Po ashtu, në këto kërkesa, IKD ka kërkuar edhe një kopje të njoftimit me shkrim që punëdhënësit u kanë dërguar të punësuarve në institucionin publik përkatës.

Nga përgjigjet që ka pranuar IKD, del se 51 institucione publike kanë njoftuar me shkrim punëtorët lidhur me të drejtat që derivojnë nga LMS, prej të cilave një (1) institucion një gjë të tillë e kishte bërë pjesërisht. Kurse, katër (4) institucione nuk kanë njoftuar të punësuarit e tyre lidhur me të drejtat që parashihen në LMS.


Ndërsa, krahas faktit se LMS e ka përcaktuar shprehimisht formën e njoftimit apo dhënies së udhëzimeve, me ç’rast kishte përdorur shprehjen “*me shkrim*”, një numër i konsiderueshëm i institucioneve nuk e kishin respektuar formën e njoftimit të përcaktuar me ligj.

Në këtë drejtim, tetë (8) institucionet publike, janë përgjigjur se njoftimin e punëtorëve me të drejtat e parapara në LMS, e kanë bërë vetëm gojarisht derisa nëntë (9) institucione të tjera publike njoftimin e punëtorëve lidhur me të drejtat që parashihen në LMS, e kishin bërë në mënyrë tjera, ku përfshihet edhe publikimi i Udhëzuesit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në faqet zyrtare të institucioneve përkatëse.

¹⁷ AKK. Intervistë përmes postës elektronike. 10 prill 2020.

¹⁸ Po aty.

Në anën tjetër, 15 institucione publike që janë përgjegjur në kërkesat e IKD-së, nuk kishin kthyer përgjigje lidhur me atë nëse janë njoftuar apo jo me shkrim punëtorët e tyre me të drejtat që parasheh LMS.



Grafika 5 – Mënyra se si institucionet publike i kanë njoftuar punëtorët e tyre lidhur me të drejtat që parasheh LMS.

Lidhur me njoftimin me shkrim mbi procedurat e sinjalizimit, AKK ka deklaruar se kjo agjenci nuk është e obliguar që të mbajë këtë evidencë, për të cilën arsye nuk ka të dhëna, duke shtuar se deri më tani, AKK nuk ka pranuar informacion zyrtar rreth mos njoftimit me shkrim të punonjësve nga ana e punëdhënësve¹⁹.

5.2.1. (Mos) respektimi i afatit ligjor për caktimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim

IKD kishte kërkuar nga institucionet publike edhe kohën se kur punëtorët e tyre ishin njoftuar me të drejtat që parasheh LMS, mirëpo, vetëm 39 nga këto institucione publike që janë përgjegjur kanë treguar kohën se kur i kishin njoftuar punonjësit e tyre.

Sa i përket institucioneve që kanë treguar periudhën kohore se kur i kanë njoftuar punonjësit e tyre lidhur me të drejtat e parapara në LMS, 15 institucione publike e kishin respektuar afatin ligjor për përmbushjen e këtij obligimi, në atë mënyrë që shtatë (7) nga këto institucione një gjë të tillë e kishin bërë në muajin mars 2019, katër (4), në muajin prill 2019, dy (2) në muajin maj 2019 dhe dy (2) në qershor 2019.

Ndërsa, 24 institucione të tjera publike që kanë treguar kohën e njoftimit të punësuarve, nuk e kanë respektuar afatin ligjor lidhur me përmbushjen e këtij obligimi të LMS-së, në atë mënyrë

¹⁹ Po aty.

që një (1) institucion publik i kishte njoftuar me shkrim të punësuarit lidhur me procedurat e sinjalizimit më 11 korrik 2019, një (1) në shtator 2019, tre (3) në tetor 2019, 10 në nëntor 2019, tre (3) në dhjetor 2019, pesë (5) në janar 2020 dhe një (1) në shkurt 2020.

Sipas përgjigjeve që IKD ka pranuar në kërkesat e saj, del se të paktën gjashtë (6) institucione publike njoftimin e punonjësve të tyre lidhur me të drejtat që parashihen në LMS, e kanë bërë tek pasi që IKD i ka pyetur institucionet në fjalë në lidhje me atë se a i kishin njoftuar punëtorët e tyre me të drejtat e parapara në LMS.

6. Rastet e sinjalizimit të brendshëm të paraqitura në institucionet publike

Për qëllime të këtij raporti hulumtues, IKD ka kërkuar informata nga institucionet publike edhe nëse që nga hyrja në fuqi e LMS-së, është paraqitur tek ta ndonjë rast i sinjalizimit të brendshëm. Një informatë e tillë ishte kërkuar vetëm si shifër statistikore, derisa nuk janë kërkuar të dhënat tjera konfidenciale.

Nga përgjigjet që IKD ka pranuar del se, kur janë bërë më shumë se një vit që kur LMS ka hyrë në fuqi, deri më tani vetëm në një (1) institucion publik është paraqitur një (1) rast i sinjalizimit. Sipas përgjigjes që institucioni në fjalë ka dhënë për IKD, rasti në fjalë ishte trajtuar sipas procedurave ligjore.

Kurse, nëntë (9) institucione tjera publike nuk kishin dhënë përgjigje lidhur me atë se a ishte paraqitur ndonjë rast i sinjalizimit tek ta, ndërsa, dy (2) institucione kishin refuzuar të përgjigjen.

Sipas përgjigjeve që IKD ka pranuar nga institucionet publike, shihet se në të paktën tek disa nga këto institucione publike mungon një informim i saktë lidhur me qëllimin dhe obligimet që rrjedhin nga LMS. Kjo pasi që siç shihet në disa nga këto përgjigje, institucione të caktuara kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit, mirëpo për një gjë të tillë nuk i kanë informuar fare punonjësit e tyre, duke ia humbur kështu edhe kuptimin vet ekzistimit të pozitës së zyrtarit për pranim dhe trajtim të sinjalizimit. Po ashtu, në përgjigje të disa institucioneve, zyrtarët përgjegjës për sinjalizim, quhen edhe si *sinjalizues* çka tregon për një mungesë të njohurisë për dallimin që kanë këto dy emërtime, përkatësisht dallimin në mes zyrtarit përgjegjës për rastet e sinjalizimit dhe vetë sinjalizuesve.

Sfidë po ashtu vazhdon të mbetet mos miratimi i akteve nënligjore për LMS-në. Një gjë e tillë, është theksuar si problem edhe në përgjigje që institucione të caktuara i kanë dhënë IKD-së, ku theksohet se në mungesë të këtyre akteve, të njëjtat institucione nuk e kanë pasur të qartë se për çfarë periudhe duhet të caktohet zyrtari përgjegjës për sinjalizim apo sa do të jetë mandati i tij dhe çështje tjera të ngjashme.

Ndërsa, krahas rastit të sinjalizimit të brendshëm që ka identifikuar IKD, AKK thotë se në institucionet publike, si sinjalizim i brendshëm është edhe një rast tjetër. “Sipas raporteve të pranuar janë 2 raste, mirëpo ky numër nuk është i saktë, për arsye se nuk kemi pranuar raportet vjetore prej të gjitha institucioneve publike” thuhet në përgjigjen e AKK-së²⁰.

Ndërsa, si sinjalizim i jashtëm, deri më tani në AKK janë paraqitur gjithsej 5 raste. “Agjencia, deri më tani ka pranuar pesë (5) raste të sinjalizimit të jashtëm, të cilat janë trajtuar brenda afateve të përcaktuara ligjore dhe brenda kompetencave të AKK” thuhet në përgjigjen zyrtare të AKK-së për IKD-në²¹.

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty.

7. Kundërvajtjet e institucioneve publike sipas LMS-së , të identifikuar nga IKD

Nga gjetjet e mësipërme mbi mos zbatimin e obligimeve ligjore sipas LMS-së nga ana e institucioneve publike, IKD ka identifikuar edhe kundërvajtjet e kryera nga këto institucione, për të cilat raste, AKK duhet që të iniciojë procedurat kundërvajtëse.

Nga monitorimi dhe hulumtimi i bërë, IKD ka identifikuar gjithsej 61 kundërvajtje të institucioneve publike.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur institucionet publike, lloji i kundërvajtjeve dhe baza ligjore sipas LMS-së:

Institucioni publik	Lloji i kundërvajtjes	Neni në LMS
Komuna e Shtërpçës	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit	Neni 27, par 1, nënpar 1.3
Komuna e Shtërpçës	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Zyra e Kryeministrit	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Ministria e Punëve të Brendshme	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Ministria e Financave	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Ministria e Zhvillimit Rajonal	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Komuna e Prizrenit	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Komuna e Dragashit	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Komuna e Hanit të Elezit	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Komuna e Novobërdës	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Gjykata Themelore në Ferizaj	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Trusti i Kursimeve Pensionale	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Kompania Rajonale Ujësjetësi “Mitrovica”	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Universiteti i Mitrovicës	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS	Neni 27, par 1, nënpar 1.2
Ministria e Shëndetësisë	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Ministria e Mbrojtjes	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Ministria e Zhvillimit Rajonal	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Komuna e Prizrenit	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Komuna e Ferizajt	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Komuna e Vushtrrisë	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Komuna e Mamushës	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.

Komuna e Kamenicës	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Gjykata Themelore në Pejë	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Gjykata Themelore në Prizren	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Gjykata Themelore në Gjilan	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Gjykata e Apelit	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Këshilli Prokurorial i Kosovës	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Institucioni i Avokatit të Popullit	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Banka Qendrore e Kosovës	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Ndërmarrja Hidro-Ekonomike “Ibër Lepenc”	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Universiteti i Gjilanit	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par 2.
Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës	Nuk ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.3 lidhur me nenin 30 par2.
Kuvendi i Kosovës	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Ministria e Mbrojtjes	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Komuna e Podujevës	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Komuna e Istogut	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Komuna e Rahovecit	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Komuna e Mamushës	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Gjykata Themelore në Prizren	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Akademia e Drejtësisë	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Agjencia Kosovare e Privatizimit	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Autoriteti i Aviacionit Civil	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Institucioni i Avokatit të Popullit	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Banka Qendrore e Kosovës	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Zyra Kombëtare e Auditimit	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Administrata Tatimore e Kosovës	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Shërbimi Korrektues i Kosovës	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Ndërmarrja Hidro-Ekonomike “Ibër-Lepenc”	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Spitali i Përgjithshëm në Prizren	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2
Universiteti i Prishtinës	Mos njoftimi me shkrim i të punësuarve me të drejtat e parapara në LMS brenda afatit ligjor	Neni 27, par 1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 30 par2

Tabela 1: Kundërvajtjet e institucioneve publike sipas LMS-së, të identifikuar nga IKD.

Por, përkundër kundërvajtjeve që IKD ka identifikuar në këtë raport, si në tabelat më lartë, AKK deri më tani nuk ka inicuar asnjë procedurë kundërvajtëse. Në përgjigjen e kësaj agjencie për IKD thuhet se deri më tani, në AKK nuk janë paraqitur raportime për ndonjë kundërvajtje sipas LMS-së²².

“Jo, sepse nuk është arritur përshkrimi faktik i veprimeve nga të cilat rezultojnë tiparet juridike të kundërvajtjes, si pasojë e ekzistimit të rrethanave, të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë e kundërvajtjes, duke përfshi këtu edhe paqartësisë ligjore (*edhe mungesën e aktit nënligjor*) dhe mungesën e udhëzimeve të qarta dhe konkrete”²³.

Në këtë rast, IKD konsideron se përgjigja e AKK-së është kundërthënëse në vete, pasi lidhur me pyetjen nëse kanë identifikuar ndonjë kundërvajtje, përgjigja është se derisa më tani nuk

²² Po aty.

²³ Po aty.

janë paraqitur raportime, derisa lidhur me iniciimin e procedurave kundërvajtëse, në përgjigje thuhet se nuk është arritur përfshkrimi faktit i veprimeve nga të cilat rezultojnë tiparet juridike të kundërvajtjes. Thënë më ndryshe, AKK thotë se nuk ka identifikuar asnjë kundërvajtje, por se në këto kundërvajtje, nuk janë përmbushur elementet e kundërvajtjes.

Në anën tjetër, IKD i rikujton AKK-së nenin 30.3 të LMS-së, i cili përcakton se *“Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Inspektorati i Punës, obligohen të fillojnë procedurat sipas Ligjit për Kundërvajtje ndaj punëdhënësve dhe zyrtarëve përgjegjës, të cilët nuk i kanë përmbushur obligimet sipas këtij ligji, jo më vonë se gjashtë (6) muaj”*.

Nisur nga fakti se obligim sipas këtij ligji është edhe caktimi i zyrtarit përgjegjës për rastet e sinjalizimit dhe njoftimi me shkrim i të punësuarve lidhur me procedurat e sinjalizimit, mungesa e informimit të AKK-së lidhur me numrin e institucioneve publike të obliguara sipas LMS-së të caktojnë zyrtarin përgjegjës dhe mos mbajtja e të dhënave të kësaj agjencia lidhur me përmbushjen dhe mos përmbushjen e obligimit të punëdhënësve për të njoftuar me shkrim të punësuarit lidhur me procedurat e sinjalizimit paraqet dështim në start të AKK-së për përmbushjen e kësaj dispozite.

Dispozita e nenin 30.3 të LMS-së është dispozitë e përgjithshme, që e vendosë AKK-në në pozitën e institucionit mbikëqyrës për të gjitha institucionet publike, veçanërisht në kuptim të iniciimit procedurës kundërvajtëse.

Si rrjedhojë, nuk ka asnjë dispozitë që në rastin konkret, e ndalon AKK-në të veproj sipas detyrës zyrtare, nëse nuk ka një ankesë të deponuar.

Për këtë arsye, në mënyrë që LMS të jep ligj përtej letrës, AKK duhet që të përmbushë detyrimet e saja në raport me të gjitha institucionet, sipas autorizime ligjore që ka, në rastin konkret iniciimit të procedurave kundërvajtëse. Arsyetimi “blanko” se nuk janë përmbushur elementet e kundërvajtjes, paraqet shmangie të AKK-së nga obligimet e saja ligjore, e cila shmangie, minon zbatimin në praktikë të AKK-së.

Andaj, IKD i rekomandon AKK-së që secilën prej kundërvajtjeve të identifikuar në tabelën nr.1 të këtij raporti, dhe kundërvajtjet e tjera, AKK ti trajtojë sipas autorizimeve ligjore që ka, duke kujtuar faktin, se tanimë edhe vet AKK ka tejkalar afatin ligjor.

8. ANEX – Zbatimi i obligimeve të dala nga LMS, nga secili institucion publik

Për të pasur një pasqyrë më të mirë lidhur me zbatimin në praktikë të LMS-së, nga të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës, IKD në këtë raport ka pasqyruar në mënyrë të detajuar edhe përgjigjet që ka pranuar nga këto institucionet lidhur me zbatimin nga ana e tyre të obligimeve që dalin nga LMS.

Kësisoj, Zyra e Presidentit të Kosovës (ZPK) ka njoftuar se zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit e ka caktuar më 26 mars 2019 dhe më të njëjtën datë i ka njoftuar edhe punonjësit e presidencës lidhur me të drejtat që parashihen në LMS. Mirëpo, ZKP nuk ka ofruar qasje në vendimin për caktim të zyrtarit përgjegjës e as nuk kanë treguar për mënyrën se si është njoftuar stafi i ZPK-së, lidhur me të drejtat që dalin nga LMS.

Sipas përgjigjes që ZPK ka dhënë për IKD-në, del Zyra e Presidentit ka caktuar zyrtarin përgjegjës, brenda afatit gjashtë (6) mujor prej hyrjes në fuqi të ligjit, ashtu siç është përcaktuar në LMS. Ndërsa sa i përket rasteve të paraqitura të sinjalizimit, siç thuhet në përgjigjen e ZPK-së, deri më 31 dhjetor 2019, nuk ka pasur asnjë rast të paraqitur.

Kuvendi i Kosovës, zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit e ka caktuar më 30 maj 2019, ndërsa, lidhur me të drejtat që parashihen në LMS, të punësuarit në Kuvendin e Kosovës, ishin njoftuar më 11 nëntor 2019, përmes email-it. Gjatë vitit, 2019, në Kuvendin e Kosovës nuk ishte paraqitur asnjë rast i sinjalizimit. Sipas kësaj, Kuvendi i Kosovës, zyrtarin përgjegjës e ka caktuar brenda afatit ligjor, ndërsa në përgjigjen e tyre, Kuvendi ka bashkangjitur edhe vendimin për caktimin e zyrtarit përgjegjës për trajtim të rasteve të sinjalizimit.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit e ka caktuar më 27 mars 2019. Lidhur me atë, se a janë njoftuar të punësuarit në Gjykatën Kushtetuese për të drejtat që parashihen në LMS, IKD nuk ka marr përgjigje. Ndërsa, edhe nga Gjykata Kushtetuese kanë njoftuar se gjatë vitit 2019, nuk kanë pasur të paraqitur asnjë rast të sinjalizimit. Në përgjigjen e tyre, Gjykata Kushtetuese nuk ka ofruar qasje në vendimin për caktimin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim.

Institucioni	Caktimi i zyrtarit përgjegjës për pranim dhe trajtim të sinjalizimit	Njoftimi me shkrim i punëtorëve me të drejtat e parapara në LMS	Rastet e paraqitura të sinjalizimit
Zyra e Presidentit të Kosovës	√	√	0
Kuvendi i Kosovës	√	√	0
Gjykata Kushtetuese	√	Nuk ka kthyer përgjigje	0

Tabela 2 – Zbatimi i obligimeve nga LMS nga ana e ZKP-së, Kuvendit dhe Gjykatës Kushtetuese.

8.1.Pushteti ekzekutiv

Lidhur me zbatimin e obligimeve që dalin nga LMS, IKD ka dërguar kërkesa për informata/qasje në dokumente publike edhe tek Zyra e Kryeministrit si dhe të gjitha ministrinë e Qeverisë së Kosovës si ushtruese të pushtetit ekzekutiv në Kosovë. Këto kërkesa, janë dërguar në kohën kur ende në detyrë ishte, Qeveria e zt. Ramush Haradinaj, e cila përbëhej nga 21 ministri.

Me formimin e Qeverisë së re, të z. Albin Kurti, numri i ministrive tashmë është zvogëluar në 15. Kjo ka bërë që ministri të caktuar, që në qeveritë e kaluara kishin funksionuar si të ndara, tashmë të bashkohen në një ministri të vetme.

Në rastin konkret, Ministria e Punëve të Brendshme si dhe ajo e Administratës Publike tashmë janë bashkuar në një ministri të vetme. Kjo ka bërë, që tashmë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe të Administratës Publike, sipas përgjigjeve që ka marr IKD, të jenë të caktuar dy zyrtarë për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit. Ministria e Punëve të Brendshme, më 27 dhjetor 2019, në kohën kur funksiononte si ministri e pavarur, në përgjigjen që kishte dhënë për IKD kishte treguar që kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për sinjalizim dhe lidhur me këtë kishin bashkangjitur edhe vendimin për caktim. Kurse, përkundër se Ministrisë së Administratës Publike, kërkesa nga IKD i ishte dërguar më 30 dhjetor 2019, përgjigje kanë kthyer tek më 19 shkurt 2020, në të cilën kanë treguar kanë treguar se “*Administrata publike në kuadër të MPBAP-së ka caktuar personin përgjegjës për rastet e sinjalizimit dhe për këtë ka njoftuar edhe organin përgjegjës*”. Lidhur me këtë përgjigje, duke qenë se nuk është bashkangjitur vendimi për caktim e as data se kur është caktuar, është e paqartë nëse bëhet fjalë për të njëjtin zyrtar për sinjalizim sikurse në përgjigjen e pranuar nga MPB apo për një zyrtar tjetër përgjegjës.

Ndryshe, në kërkesat e IKD-së lidhur me zbatimin e obligimeve që dalin nga LMS, përgjigje kanë kthyer Zyra e Kryeministrit dhe 16 ministri. Sipas këtyre përgjigjeve, del se Zyra e Kryeministrit dhe 16 ministri kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit. Sa i përket njoftimit së të punësuarve në këto institucionet, lidhur me të drejtat që parashihen në LMS, tetë (8) institucione i kanë njoftuar me shkrim punonjësit e tyre me këto të drejta, ndërsa pesë (5) tjera, njoftimin e tillë e kishin bërë vetëm gojarisht ose në mënyra tjera ku përfshihet publikimi i udhëzuesit për trajtim të rasteve të sinjalizimit. Tetë (8), ministri nuk kanë kthyer përgjigje fare lidhur me atë se a i kishin njoftuar të punonjësit e tyre me të drejtat që parashihen në LMS.

Zyra e Kryeministrit dhe tetë (8) ministri, zyrtarët përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit i kanë caktuar brenda afatit prej gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të LMS-së, kurse gjashtë (6) ministri këtë e kishin bërë pas kalimit të këtij afati. Gjashtë (6) ministri nuk kanë kthyer përgjigje lidhur me kohën e caktimit të zyrtarëve përgjegjës.

Sa i përket rasteve të paraqitura të sinjalizimit, del se në asnjërën nga këto institucione nuk ishte paraqitur ndonjë rast i tillë, përjashtimit shtatë (7) ministrive të cilat nuk janë përgjigjur

në kërkesat e IKD-së e për të cilat rrjedhimisht nuk është ofruar informacion nëse ka pasur ndonjë rast të paraqitur.

Në anën tjetër, vetëm shtatë (7) ministri kanë ofruar qasje në vendimet për caktimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim. Ndër to është edhe Ministria e Shëndetësisë. IKD kërkesën për informata/qasje në dokumente publike në MSH e kishte bërë më 27 dhjetor 2019, kurse përgjigjen e kishte pranuar më 15 janar 2020. Në përgjigjen që kjo e fundit ka dhënë për IKD, lidhur me kohën e caktimit të zyrtarit përgjegjës për sinjalizim, thuhet se një gjë e tillë është bërë në muajin mars 2019. “Për pyetjen 1 dhe 2: Caktimi i zyrtarit në këtë pozitë është bërë me datë 11.03.2019(Bashkëngjitur vendimi)”.²⁴ Mirëpo, sipas vendimit që MSH ia ka bashkëngjitur përgjigjes së saj për IKD-në, shihet se vendimi mban datën 9 janar 2019, apo vetëm pesë (5) ditë pas hyrjes në fuqi të LMS, apo mbi 2 muaj para se AKK të kërkojë nga institucionet publike caktimin e zyrtarëve përgjegjës. Por, numri i vendimit në këtë rast është shënuar si 01/I/2020, kurse ndërsa protokollimi mban datën 9 janar 2020. Nga kjo shihet se ose kemi të bëjmë me një gabim teknik ose tentim të fshehjes së datës së saktë të caktimit të zyrtarit përgjegjës për sinjalizim. Për më tepër, data e vendimit 9 janar 2019, e cila figuron në këtë vendim nuk ka mundësi të jetë e saktë, pasi arsyetimi i këtij vendimi i referohet shkesës së AKK-së të datës 11 mars 2019. Thënë më ndryshe, ky vendim është nxjerrë mbi bazën e shkresës së AKK-së mbi dy (2) muaj para se të dërgohet kjo shkresë, çfarë objektivisht është e pamundur. Për këtë arsye, IKD kërkon nga AKK që të hap procedurë kundërvajtëse ndaj Ministrisë së Shëndetësisë, dhe të qartësohet edhe situata e këtij vendimi.

MZHR zyrtarin e saj përgjegjës për pranim dhe trajtim të sinjalizimit e kishte caktuar tek më 27 dhjetor 2019, apo jashtë afatit gjashtë (6) të përcaktuar në LMS. Mirëpo, për këtë vonesë në caktimin e zyrtarit përgjegjës, MZHR e ka lënë përgjegjëse AKK, e cila sipas MZHR-së, nuk u kishte dërguar kërkesën për caktimin e zyrtarit përgjegjës, me arsyetimin se kanë harruar t’i përfshijnë në kërkesën për caktim që ishte bërë në mars 2019 nga AKK.

Lidhur me obligimin që të njoftohen të punësuarit në institucione me të drejtat që parashihen në LMS, Ministria e Bujqësisë në përgjigjen që ka dhënë për IKD-në, më 30 dhjetor 2019, ka treguar se një njoftim i tillë është bërë vetëm pjesërisht, ndërsa pas kërkesës së IKD, të njëjtit kanë premtuar se do të njoftojnë stafin lidhur me këtë të drejta.

²⁴ Përgjigja e Ministrisë së Shëndetësisë për IKD-në, data 15 janar 2020.

Institucioni	Caktimi i zyrtarit përgjegjës për pranimit dhe trajtim të sinjalizimit	Njoftimi me shkrim i punëtorëve me të drejtat e parapara në LMS	Rastet e paraqitura të sinjalizimit
Zyra e Kryeministrit	√	X	0
Ministria e Punëve të Brendshme	√	X	0
Ministria e Punëve të Jashtme	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Ministria Financave	√	X	0
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	√	Nuk ka kthyer përgjigje	0
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Ministria e Shëndetësisë	√	√	0
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	√	√	0
Ministria e Drejtësisë	√	√	0
Ministria e Mbrojtjes	√	√	0
Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike	√	√	0
Ministria për Kthim dhe Komunitete	√	√	0
Ministria e Infrastrukturës	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	√	√	0
Ministria e Integritimit Evropian	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Ministria e Tregtisë, Industrisë	√	Nuk ka kthyer përgjigje	0
Ministria e Mjedisit, Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor	√	X	Nuk kanë pranuar të përgjigjen
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	√	Nuk ka kthyer përgjigje	0
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	√	√	0
Ministria e Administratës Publike	√	Nuk ka kthyer përgjigje	0
Ministria e Zhvillimit Rajonal	√	X	0

Tabela 3 – Zbatimi i obligimeve nga LMS, nga ana pushtetit ekzekutiv.

8.2.Pushteti lokal

IKD ka analizuar implementimin e LMS-së edhe nga organet e pushtetit lokal në Kosovë. Nga kërkesat për informata/qasje në dokumente publike që IKD u ka dërguar komunave, ka pranuar 21 përgjigje kurse 10 të tjera nuk kanë kthyer përgjigje²⁵.

Nga 21 komunat që janë përgjigjur në kërkesat e IKD-së, del se 20 komuna kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit kurse Komuna e Shtërpcës nuk e ka caktuar zyrtarin përgjegjës.

Nga këto 20 komuna që veç se i kanë caktuar zyrtarët përgjegjës, 15 nga to një gjë të tillë e kishin bërë brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes së në fuqi të LMS-së, kurse pesë (5) komuna të tjera, caktimin e zyrtarit në fjalë e kishin bërë pas kalimit të këtij afati.

Tri (3) komuna, zyrtarin përgjegjës e kishin caktuar vetëm pas kërkesave që IKD u kishte dërguar atyre, lidhur me atë se a e kishin caktuar zyrtarin për trajtim të rasteve të sinjalizimit. Konkretisht, IKD kërkesat në fjalë u kishte dërguar të gjitha komunave më 8 janar 2020, kurse, Komuna e Prizrenit ka njoftuar se zyrtarin për trajtim të rasteve të sinjalizimit e kishte caktuar tek më 15 janar 2020, Komuna e Kamenicës një gjë të tillë e kishte bërë më 16 janar 2020 kurse ajo e Mamushës më 24 janar 2020.

Qasje IKD-së në vendimet për caktim të zyrtarëve përgjegjës, kanë dhënë 17 komuna kurse tri (3) komuna nuk kanë ofruar qasje në një dokument të tillë.

Sa i përket njoftimit së të punësuarve lidhur me të drejtat që parashihen në LMS, 13 komuna një gjë të tillë e kanë bërë me shkrim, dy (2), komuna një njoftim të tillë e kishin bërë gojarisht apo përmes publikimit të udhëzuesit për sinjalizuesit në ueb faqe, tri (3) komuna nuk kishin njoftuar fare të punësuarit me të drejtat e parapara në LMS, ndërsa, dy (2) komuna nuk kanë kthyer përgjigje nëse kishin njoftuar apo jo, të punësuarit e tyre.

Dy (2) komuna, ajo e Kamenicës dhe Mamushës, njoftimin e punonjësve të tyre lidhur me të drejtat që parashihen në LMS, e kishin bërë vetëm pasi që IKD u kishte dërguar kërkesat për informata, në të cilat i kishte pyetur këto komuna nëse i kanë informuar zyrtarët e tyre lidhur me të drejtat e parapara në LMS.

Nga të gjitha komunat që janë përgjigjur në kërkesat e IKD-së, 18 nga to kanë treguar se nuk kanë pasur asnjë rast të sinjalizimit të paraqitur, kurse, tri (3) komuna nuk janë përgjigjur nëse kanë pasur raste të tilla.

²⁵ *Shënim:* IKD ka dërguar kërkesë për qasje në informata dhe dokumente publike 31 nga 38 komunat e Republikës së Kosovës. Arsyeja pse në shtatë (7) komuna me shumicë serbe nuk është dërguar kërkesë për informata dhe qasje në dokumente publike ka të bëjë me mungesën e adresave elektronike të këtyre komunave në faqet e tyre zyrtare. Për më tepër, nga 31 kërkesat për informata dhe qasje në dokumente publike të dërguara nga IKD, Komuna e Suharekës fillimisht nuk ka kthyer përgjigje. Me rastin e rikujtimit të kësaj kërkesë, Komuna e Suharekës ka thënë se i është përgjigjur kësaj kërkesë muaj më parë, por se kjo përgjigje nuk është askund.

Institucioni	Caktimi i zyrtarit përgjegjës për pranim dhe trajtim të sinjalizimit	Njoftimi me shkrim i punëtorëve me të drejtat e parapara në LMS	Rastet e paraqitura të sinjalizimit
Komuna e Prishtinës	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Komuna e Mitrovicës së Jugut	√	√	0
Komuna e Pejës	√	√	0
Komuna e Gjakovës	√	√	0
Komuna e Prizrenit	√	X	0
Komuna e Gjilanit	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Komuna e Ferizajt	√	√	0
Komuna e Deçanit	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Komuna e Dragashit	√	X	0
Komuna e Fushë Kosovës	√	Nuk ka kthyer përgjigje	0
Komuna e Drenasit	√	√	0
Komuna Graçanicës	√	√	0
Komuna Hanit të Elezit	√	X	0
Komuna e Kaçanikut	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Komuna e Vitisë	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Komuna e Podujevës	√	√	0
Komuna e Vushtrrisë	√	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Komuna e Skenderajt	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Komuna e Klinës	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Komuna e Istogut	√	√	0
Komuna e Junikut	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Komuna Rahovecit	√	√	0
Komuna e Malishevës	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Komuna e Mamushës	√	√	0

Komuna e Shtërpcës	X	X	0
Komuna e Lipjanit	√	√	0
Komuna e Shtëmës	√	√	0
Komuna e Obiliqit	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Komuna e Kamenicës	√	√	0
Komuna e Novobërdës	√	X	0
Komuna e Suharekës	/	/	/

Tabela 4 – Zbatimi i obligimeve nga LMS nga ana e pushtetit lokal.

8.3.Sistemi i drejtësisë

IKD ka dërguar kërkesa për informata/qasje në dokumente publike lidhur me zbatimin e obligimeve që dalin nga LMS, edhe në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) si dhe në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës, mirëpo, interesimi i tyre për tu përgjigjur lë shumë për të dëshiruar.

Kjo pasi që nga 20 kërkesat e dërguara nga IKD, vetëm shtatë (7) institucione janë përgjigjur, kurse 13 të tjera nuk janë përgjigjur, përkundër se të njëjtave institucione të sistemit të drejtësisë edhe u janë përsëritur kërkesat.

Nga këto shtatë (7) institucione që janë përgjigjur, del se të gjitha ato i kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për pranimit dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit.

Mirëpo, vetëm dy (2) nga to, zyrtarin përgjegjës e kishin caktuar brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes së në fuqi të LMS-së, kurse pesë (5) të tjera, caktimin e zyrtarit në fjalë e kishin bërë pas kalimit të këtij afati prej gjashtë (6) muajve, që është caktuar në LMS.

Caktimin e zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim, Gjykata Themelore në Pejë, Gjykata Themelore në Prizren si dhe ajo në Gjilan, e kishin bërë vetëm pasi që IKD, u kishte dërguar këtyre gjykatave kërkesat për informata me pyetjen nëse të njëjtat kishin caktuar zyrtarët përgjegjës.

IKD, më 9 janar 2020 kishte dërguar kërkesat për informata në Gjykatat Themelore në Pejë, Prizren dhe Gjilan, kurse, zyrtarët përgjegjës për sinjalizim ishin caktuar nga Gjykatat Themelore në Pejë dhe Prizren ishin caktuar më 13 janar 2020, ndërsa nga Gjykata Themelore në Gjilan, zyrtari përgjegjës ishte caktuar më 20 janar 2020.

Nga këto shtatë (7) institucione të sistemit të drejtësisë që kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për sinjalizim, pesë (5) nga to kanë ofruar qasje në vendimet për caktim, kurse dy (2) institucione nuk e kishin bërë një gjë të tillë.

Sa i përket njoftimit me shkrim së të punësuarve në këto institucione të sistemit të drejtësisë për të drejtat që parashihet LMS, dy (2) institucione kanë njoftuar se e kishin bërë një njoftim të tillë me shkrim, dy (2) institucione tjera kanë treguar se një njoftim të tillë e kishin bërë gojarisht apo përmes publikimit të udhëzuesit për sinjalizuesit në ueb faqet e tyre, ndërsa katër (4) institucione nuk kanë kthyer përgjigje nëse kishin njoftuar apo jo të punësuarit e tyre lidhur me të drejtat që parashihet LMS.

Gjykata Themelore në Prizren, njoftimin e punonjësve të saj lidhur me të drejtat që parashihen në LMS, e kishte bërë tek pasi për një gjë të tillë ishte pyetur nga ana e IKD-së. Konkretisht, IKD kishte dërguar kërkesën për informata në Gjykatën Themelore në Prizren më 9 janar 2020, ndërsa njoftimin e punonjësve të saj, gjykata në fjalë e kishte bërë 13 janar 2020.

Sipas përgjigjeve që IKD ka pranuar, del se në gjashtë (6) institucione nuk ka pasur ndonjë rast të sinjalizimit, kurse një (1) institucion nuk ka kthyer përgjigje nëse tek ta është paraqitur ndonjë rast i sinjalizimit.

Institucioni	Caktimi i zyrtarit përgjegjës për pranim dhe trajtim të sinjalizimit	Njoftimi me shkrim i punëtorëve me të drejtat e parapara në LMS	Rastet e paraqitura të sinjalizimit
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	√	X	0
Gjykata Supreme	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Gjykata e Apelit	√	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Gjykata Themelore në Prishtinë	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Gjykata Themelore në Mitrovicë	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Gjykata Themelore në Pejë	√	√	0
Gjykata Themelore në Gjakovë	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Gjykata Themelore në Prizren	√	√	0
Gjykata Themelore në Gjilan	√	Nuk ka kthyer përgjigje	0
Gjykata Themelore në Ferizaj	√	X	0
Këshilli Prokurorial i Kosovës	√	√	0
Prokuroria e Apelit	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Prokuroria Speciale	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Prokuroria Themelore në Prishtinë	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Prokuroria Themelore në Mitrovicë	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Prokuroria Themelore në Pejë	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Prokuroria Themelore në Mitrovicë	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Prokuroria Themelore në Gjakovë	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Prokuroria Themelore në Prizren	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Prokuroria Themelore në Gjilan	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje

Prokuroria Themelore në Ferizaj	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
---------------------------------	-------------------------	-------------------------	-------------------------

Tabela 5 – Zbatimi i obligimeve nga LMS-së nga ana e institucioneve të sistemit të drejtësisë.

8.4. Agjencitë e pavarura

Lidhur me zbatimin e obligimeve të dala nga LMS, IKD ka dërguar edhe 31 kërkesa për informata/qasje në dokumente publike në 31 agjenci/institucione të pavarura të Republikës së Kosovës.

Në këto kërkesa, IKD ka pranuar përgjigje nga 23 institucione publike kurse tetë (8) të tjera nuk janë përgjigjur.

23 institucionet që janë përgjigjur në kërkesat e IKD-së kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit.

Nga 23 agjencitë e pavarura që kanë caktuar zyrtarin për sinjalizim, del se 20²⁶ nga to një gjë të tillë e kishin bërë brenda afatit gjashtë (6) mujor pas hyrjes në fuqi të LMS-së, kurse tri (3) të tjera e zyrtarin përgjegjës e kanë caktuar pas kalimit të këtij afati ligjor.

Qasje në vendimet për caktim të zyrtarëve përgjegjës kanë ofruar 11 institucione publike kurse një gjë të tillë nuk e kanë bërë 12 institucione të tjera publike.

Sa i përket njoftimit të të punësuarve me të drejtat që parashihen në LMS, 16 agjenci një njoftim të tillë e kishin bërë me shkrim, pesë (5) nga to e kishin bërë vetëm gojarisht apo me anë të publikimit të Udhëzuesit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në faqen e tyre zyrtare, kurse dy (2) agjenci nuk janë përgjigjur.

Lidhur me njoftimin e të punësuarve, nga përgjigjet që IKD ka pranuar, shihet se tri (3) institucione njoftimin e kishin bërë pas kërkesave për informata që IKD u kishte dërguar të njëjtëve.

Kështu, IKD kishte dërguar kërkesat për informata në Autoritetin e Aviacionit Civil (AAV) dhe tek Institucioni i Avokatit të Popullit më 10 janar 2020, kurse në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) më 13 janar 2020. Nga dokumentet që këto institucione i kanë bashkangjitur në përgjigjet e tyre për IKD-në, shihet se, AAV, punonjësit e saj i kishte njoftuar përmes adresës elektronike më 13 janar 2020, Institucioni i Avokatit të Popullit më 14 janar 2020, ndërsa ATK më 12 shkurt 2020.²⁷

Tek agjencitë e pavarura, sipas përgjigjeve që ka pranuar IKD, del se është paraqitur edhe rasti i vetëm i sinjalizimit. Përkatësisht, Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës, ka njoftuar se ka pranuar një (1) rast të sinjalizimit, për të cilën kanë thënë se e kanë trajtuar sipas ligjit.

²⁶ *Shënim:* Agjencioni për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, në përgjigjen që ka dhënë për IKD, ka treguar se zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit e ka caktuar pas datës 2 korrik 2019, por se kjo vonesë në caktimin e zyrtarit përgjegjës ka ardhur pasi që kjo agjenci gjatë vitit 2019, kur kishte hyrë në fuqi LMS, kishte pasur vetëm 12 të punësuar dhe rrjedhimisht nuk kanë qenë të obliguar sipas LMS, të kenë zyrtar përgjegjës. Më vonë, me shtimin e numrit të punësuarve në mbi 15, agjencia kishte caktuar një zyrtar për trajtim të rasteve të sinjalizimit.

²⁷ *Shënim:* Në përgjigjet e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe ATK-së, thuhet se të punësuarit janë njoftuar edhe më herët, mirëpo, sipas dokumenteve që këto institucione ju kanë bashkangjitur përgjigjeve të tyre, shihet se njoftimi me shkrim i të punësuarve të tyre është bërë pas kërkesave të dërguara nga ana e IKD-së.

Dy (2) agjenci të tjera nuk kanë pranuar të japin informacione nëse kanë pasur ndonjë rast të sinjalizimit që është paraqitur tek to, dy (2) agjenci tjera nuk janë përgjegjgur nëse kanë pasur ndonjë rast të sinjalizimit, kurse, 18 agjenci të tjera kanë treguar se nuk kanë pasur asnjë rast të sinjalizimit të paraqitur.

Institucioni	Caktimi i zyrtarit përgjegjës për pranim dhe trajtim të sinjalizimit	Njoftimi me shkrim i punëtorëve me të drejtat e parapara në LMS	Rastet e paraqitura të sinjalizimit
Agjencia për Barazi Gjinore	√	√	0
Agjencia e Statistikave të Kosovës	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Agjencia Kosovare e Privatizimit	√	√	0
Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale	√	X	0
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	√	√	0
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	√	X	0
Autoriteti i Aviacionit Civil	√	√	1
Avokati i Popullit	√	√	0
Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit	√	X	Nuk pranojnë të përgjigjen
Banka Qendrore e Kosovës	√	√	Nuk kanë pranuar të përgjigjen ²⁸

²⁸ Në përgjigjen e tyre, BQK nuk ka pranuar të jap informacione lidhur me atë nëse kanë pasur ndonjë rast të sinjalizimit, duke u thirrur në nenin 11 të LMS-së, i cili nen bën fjalë për konfidencialitetin. Më gjithë këtë, IKD në kërkesën e saj të dërguar në të gjitha institucionet publike, ka kërkuar vetëm të di vetëm si numër, nëse është paraqitur ndonjë rast i sinjalizimit apo jo dhe assesit të dhëna tjera që mund të jenë konfidenciale dhe të rrezikojnë edhe vet sinjalizuesin.

Radio Televizioni i Kosovës	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	√	X	0
Komisioni i Pavarur për Media	√	√	0
Komisioni Rregullativ i Prokurimit	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	√	√	0
Komisioni Kosovar i Konkurrencës	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	√	√	0
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik	√	√	0
Trusti i Kursimeve Pensionale	√	X	0
Zyra Kombëtare e Auditimit	√	√	0
Zyra e Rregullatorit për Energji	√	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Autoriteti Rregullator për Shërbime e Ujit	√	√	0
KOSTT – Operator Sistemi Transmisioni dhe Tregu	√	√	0
Dogana e Kosovës	√	√	0
Administrata Tatimore e Kosovës	√	√	0
Agjencia e Arkivave	√	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Shërbimi Korrektues i Kosovës	√	√	0

Tabela 6 – Zbatim i obligimeve nga LMS nga ana e agjencive të pavarura.

8.5.Ndërmarrjet Publike

IKD ka analizuar zbatimin e obligimeve që dalin nga LMS edhe nga ana e Ndërmarrjeve Publike.

Për këtë, IKD u është drejtuar me kërkesa për informata/qasje në dokumente publike, 13 ndërmarrjeve publike të nivelit qendror dhe atij lokal.

Nga këto kërkesa të dërguara, IKD ka pranuar përgjigje nga shtatë (7) ndërmarrje kurse pestë (6) të tjera nuk janë përgjigjur.

Nga këto shtatë (7) institucione që janë përgjigjur në kërkesat e IKD-së, del se të gjitha ato i kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për pranim dhe trajtim të sinjalizimit.

Pesë (5) ndërmarrje publike, zyrtarët përgjegjës për sinjalizim i kanë caktuar brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të LMS-së, një (1) ndërmarrje publike zyrtarin në fjalë e ka caktuar pas kalimit të këtij afati, kurse një (1) ndërmarrje publike nuk ka kthyer përgjigje lidhur me kohën e caktimit të zyrtarit përgjegjës për sinjalizim.

Katër (4) ndërmarrje publike kanë ofruar qasje në vendimet për caktim të zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim kurse tri (3) ndërmarrje publike nuk e kanë bërë një gjë të tillë.

Sa i përket njoftimit të të punësuarve në ndërmarrjet publike lidhur me të drejtat që parasheh LMS, vetëm tri (3) institucione një njoftim të tillë e kishin bërë me shkrim, një (1) ndërmarrje një gjë të tillë e kishte bërë vetëm gojarisht, kurse dy (2) ndërmarrje tjera nuk kanë kthyer përgjigje nëse i kanë njoftuar apo jo të punësuarit e tyre lidhur me të drejtat e parapara në LMS.

E në një rast sui generis, një ndërmarrje publike e nivelit qendror, përkundër se ka caktuar zyrtarin përgjegjës për sinjalizim, të njëjtin ka vendosur të mbaj të fshehur nga të punësuarit tjerë. Për më tepër, zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit, kjo ndërmarrje e ka quajtur si “*sinjalizues*”.

Në përgjigjen që IKD ka pranuar nga kjo ndërmarrje (*Kompania për Menaxhimin e Deponimeve të Kosovës*) thuhet se për caktimin e zyrtarit përgjegjës e kanë njoftuar AKK-në, mirëpo, sipas tyre, nuk janë njoftuar punonjësit e kompanisë, me arsyetimin se me qëllim që zyrtari në fjalë të jetë i suksesshëm në punën e tij, do të ishte më mirë që të mos të jenë të informuar punonjësit tjerë të ndërmarrjes në fjalë.

Sipas LMS-së, krejt qëllimi i caktimit të zyrtarit përgjegjës për pranim dhe trajtim të sinjalizimit është që të punësuarit në një institucion të caktuar, përkatësisht, sinjalizuesit potencial, të kenë një adresë brenda institucionit ku do të mund të drejtoheshin lidhur me keqpërdorimeve të mundshme për të cilët sinjalizuesit do të donin të trajtoheshin. Mos informimi i të punësuarve lidhur me identitetin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim brenda institucionit, ia humb komplet kuptimin edhe vet ekzistimit të një pozite të tillë, pasi në mungesë të informatave, do të ishte e pamundur për sinjalizuesit potencial të drejtoheshin për tek zyrtari përgjegjës për sinjalizim.

Në këtë rast, me faktin se në përgjigje që IKD ka pranuar nga kjo ndërmarrje, zyrtari përgjegjës për pranim dhe trajtim të sinjalizimit, quhet sinjalizues, paraqet një mungesë serioze të informimit të saktë se çfarë parasheh LMS dhe cilat janë dallimet mes zyrtarëve për pranim dhe trajtim të sinjalizimit dhe vet sinjalizuesve.

Mos kuptim i saktë i LMS dhe dallimeve mes sinjalizuesve dhe zyrtarëve përgjegjës për pranim dhe trajtim të rasteve të sinjalizimit, shihet edhe në një përgjigje tjetër që IKD ka pranuar nga një ndërmarrje publike e nivelit lokal (KRU Prishtina). Në këtë përgjigje, ku autor është vet zyrtari i caktuar për trajtim të rasteve të sinjalizimit, i njëjti veten e quan me termin sinjalizues. *“Për ma tepër besoj se tani e tutje jemi në kontakt direkt me mua si person i emëruar “sinjalizues”, qe për këtë detyrë deklarohej se do ta kryej punën me përkushtim dhe korrektësi.”* – përgjigja e ndërmarrjes publike në fjalë për IKD.

Ndryshe, sa i përket rasteve të paraqitura të sinjalizimit, gjashtë (6) ndërmarrje publike kanë njoftuar se nuk kanë pasur asnjë rast të paraqitur, kurse, një (1) institucion nuk kanë kthyer përgjigje.

Institucioni	Caktimi i zyrtarit përgjegjës për pranim dhe trajtim të sinjalizimit	Njoftimi me shkrim i punëtorëve me të drejtat e parapara në LMS	Rastet e paraqitura të sinjalizimit
Koorporata Energjetike e Kosovës	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Ndërmarrje Hidro-Ekonomike “Ibër Lepenc”	√	√	0
Aerporti Ndërkombëtar i Prishtinës	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Telekomi i Kosovës	√	√	0
Posta e Kosovës	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës “Trainkos”	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infrakos”	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës	√	X	0
Kompania Ujësjiellësi Rajonal “Prishtina”	√	√	0
Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Hidroregjioni Jugor”	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Mitrovica”	√	X	0
Kompania Rajonale Ujësjiellësit “Hidromorava”	√	√	0
Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Gjakova”	√	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje

Tabela 7 – Zbatimi i obligimeve nga LMS nga ana e ndërmarrjeve publike.

8.6. Institucionet tjera

Një analizë të zbatimit të obligimeve që parashihen në LMS, nga ana e institucioneve publike IKD ka bërë edhe në institucionet e sigurisë, të shëndetësisë, arsimit, etj.

Policia e Kosovës, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI) si dhe Akademia e Drejtësisë, në përgjigjet që kanë dhënë për IKD, kanë njoftuar se kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për pranim dhe trajtim të sinjalizimit dhe një gjë të tillë e kanë bërë brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të LMS. Përderisa Policia e Kosovës dhe AKI nuk kanë ofruar qasje në vendimet për caktim të zyrtarëve përgjegjës, një gjë të tillë e ka bërë Akademia e Drejtësisë.

Ajo çka vërehet në rastin e Akademisë së Drejtësisë, është se të njëjtit kanë njoftuar se zyrtarin përgjegjës për sinjalizim e kanë caktuar qysh më 26 nëntor 2018, kohë në të cilën nuk kishte qenë në fuqi LMS. Në dokumentet që ka bashkangjitur Akademia e Drejtësisë në përgjigjen e saj për IKD, shihet se më 26 nëntor 2018, Akademia kishte caktuar zyrtarin për sa i përket konfliktit të interesit, kurse nuk është e qartë nëse në ndërkohë i njëjti zyrtar është caktuar të jetë edhe zyrtar përgjegjës për sinjalizim.

Ndryshe, që të tri këto institucione, Policia e Kosovës, AKI dhe Akademia e Drejtësisë kanë njoftuar të punësuarit e tyre lidhur me të drejtat që parashihen në LMS, kurse sipas përgjigjeve të tyre, del se në asnjërin nga këto tri (3) institucione nuk ka pasur ndonjë rast të sinjalizimit të paraqitur.

IKD ka analizuar zbatimin e obligimeve që dalin nga LMS, edhe një sektor që ka mijëra të punësuar, siç është sektori i shëndetësisë. Mirëpo, përgjigje në kërkesat e IKD-së, kanë dhënë vetëm nga Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK) dhe Spitali Rajonal i Prizrenit.

Në përgjigjen e saj, SHSKUK ka njoftuar se kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për sinjalizim, mirëpo, nuk kanë treguar datën se kur është bërë një caktim i tillë dhe as nuk kanë ofruar qasje në vendimin për caktim. Gjithashtu, nga SHSKUK nuk kanë treguar nëse tek ta është paraqitur ndonjë rast i sinjalizimit.

Ndërsa, në përgjigjen që Spitali i përgjithshëm në Prizren, ka dhënë për IKD, nuk tregohet nëse i njëjti ka caktuar ndonjë zyrtar përgjegjës për sinjalizim, mirëpo, vetëm thuhet se stafi është njoftuar me udhëzuesin për mbrojtjen e sinjalizuesve. Po ashtu, nuk ka përgjigje as nëse në këtë spital është paraqitur ndonjë rast i sinjalizimit.

IKD ka analizuar implementimin e LMS edhe nga ana e institucioneve të arsimit të lartë. Kështu, IKD u është drejtuar me kërkesa për informata dhe qasje në dokumente publike Agjencisë së Akreditimit dhe shtatë universiteteve publike në Kosovë. Përgjigje kanë kthyer vetëm katër (4) universitete.

Që të katër (4) këto universitet kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për sinjalizim, prej të cilave tri (3) nga to një gjë të tillë e kishin bërë brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të LMS-së, kurse një (1), e kishte bërë pas kalimit të këtij afati ligjor.

Po ashtu, të katër (4) këto universitete kanë ofruar qasje në vendimet për caktim të zyrtarëve përgjegjës. Tri (3) nga to, kanë bërë të ditur se i kanë njoftuar me shkrim punonjësit e tyre lidhur me të drejtat që dalin nga LMS, kurse, një (1) nga to ka bërë të ditur se një njoftim të tillë e ka bërë përmes publikimit të Udhëzuesit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në ueb faqen e tyre.

Në asnjërën prej këtyre katër (4) institucioneve publike, nuk del se është paraqitur ndonjë rast i sinjalizimit.

Institucioni	Caktimi i zyrtarit përgjegjës për pranim dhe trajtim të sinjalizimit	Njoftimi me shkrim i punëtorëve me të drejtat e parapara në LMS	Rastet e paraqitura të sinjalizimit
Policia e Kosovës	√	√	0
Agjencia Kosovare për Inteligjencë	√	√	0
Akademia e Drejtësisë	√	√	0
Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës	√	X	Nuk ka kthyer përgjigje
Spitali i përgjithshëm Mitrovicë	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Spitali i përgjithshëm Pejë	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Spitali i përgjithshëm Gjakovë	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Spitali i përgjithshëm Prizren	X	√	Nuk ka kthyer përgjigje
Spitali i përgjithshëm Ferizaj	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Agjencia për Akreditim	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Universiteti i Prishtinës	√	√	0
Universiteti i Mitrovicës	√	X	0
Universiteti i Pejës	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Universiteti i Gjakovës	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Universiteti i Prizrenit	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje
Universiteti i Gjilanit	√	√	0
Universiteti i Ferizajt	√	√	0
Agjencia e Kosovës për Forenzikë	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje	Nuk ka kthyer përgjigje

Tabela 8 – Zbatimi i obligimeve nga LMS nga ana e institucioneve të sigurisë, shëndetësisë dhe të arsimit të lartë.

9. Konkluzionet

- Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve i cili ka hyrë në fuqi më 2 janar 2019, për dallim nga Ligji paraprak për Mbrojtjen e Informatorëve, ka ndërtuar një sistem të konsoliduar në fushën e sinjalizimit. Me qëllim të sendërtimit në praktikë të këtij sistemi, ky ligj ka përcaktuar obligime dhe afate ligjore për të gjitha institucionet publike dhe private.
- Sipas LMS-së, të gjitha institucionet publike që kanë mbi 15 punëtorë kanë qenë të obliguara që deri më 2 korrik 2019 të caktojnë zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit. Po ashtu, obligim i institucioneve publike ka qenë edhe njoftimi me shkrim i të gjithë punonjësve lidhur me procedurat e sinjalizimit.
- Qeveria me propozim të MD-së ka qenë e obliguar që deri më 2 korrik 2019 të miratojë legjislacionin sekondar në fushën e sinjalizimit.
- Mos përmbushja e obligimeve ligjore sipas LMS-së sanksionohet si kundërvajtje, ku për institucionet publike është sanksionuar edhe dënimi me gjobë prej 500 deri në 20.000 euro.
- Për të gjitha obligimet ligjore të pa përmbushura nga institucionet publike, AKK obligohet që brenda gjashtë (6) muajve të iniciojë procedurat kundërvajtëse.
- Deri më tani, AKK nuk ka iniciuar asnjë procedurë kundërvajtëse.
- Sipas përgjigjeve të pranuar nga IKD, jo të gjitha institucionet publike e kanë të qartë LMS-në, mënyrën dhe procedurën e funksionimit të tij si dhe obligimet që këto institucione kanë përballë këtij ligji. Për më tepër, vërehen disa mos kuptime elementare, siç është dallimi në mes zyrtarit përgjegjës për rastet e sinjalizimit dhe sinjalizuesve, faktit se emri i zyrtarit përgjegjës duhet të dihet nga të punësuarit etj. Kësaj paqartësie të institucioneve publike i ka kontribuar edhe mungesa e legjislacionit sekondar.
- Nisur nga fakti se LMS është ende në fazën e konsolidimit, mungesa e njohurive lidhur me fushën e sinjalizimit nga ana e institucioneve publike paraqet sfidë serioze në zbatimin e LMS-së, veçanërisht në rastet kur në institucionet publike paraqiten raste të sinjalizimit të brendshëm.
- Nga 137 kërkesat për informata dhe qasje në dokumentet publike, 50 institucione publike nuk e kanë respektuar Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, duke mos dhënë qasje në informatat dhe dokumentet që me ligj kategorizohen si publike.
- Për shkak të mungesës së kontakteve në faqen e tyre zyrtare, IKD e ka pasur të pamundur që të dërgojë kërkesë për informata dhe qasje në dokumentet publike në shtatë (7) komunat me shumicë serbe.
- Nga të gjitha institucionet që janë përgjigjur në kërkesat e IKD-së, të paktën njëra nga to nuk ka caktuar fare zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit.
- Në caktimin e zyrtarëve përgjegjës për rastet e sinjalizuesve, 23 institucione kanë shkelur afatin ligjorë prej gjashtë (6) muajve.
- AKK deklaroi se 185 institucione publike e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit, derisa jo të gjitha këtë obligim e kanë përmbushur brenda afatit ligjor. AKK deklaroi se në mungesë të informatave lidhur me numrin e institucioneve publike

të obliguara sipas LMS-së për caktimin e zyrtarëve përgjegjës, nuk mund ta dijë se sa institucione publike nuk e kanë përmbushur fare këtë obligim ligjor.

- Në nëntë (9) raste, institucionet publike kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit vetëm pasi IKD ka dërguar kërkesë për informata dhe qasje në dokumente publike në institucionet respektive.
- Nisur nga fakti se zyrtari përgjegjës për rastet e sinjalizimit caktohet thjesht me nxjerrjen e një vendimi nga punëdhënësi, shkelja e afatit ligjor në këtë rast paraqet mos seriozitet të këtyre institucioneve publike përballë LMS-së.
- AKK nuk ka ofruar qasje në emrat e zyrtarëve përgjegjës, me arsyetimin se janë duke e shqyrtuar mundësinë që kjo çështje të zbatohet në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.0020
- Për shkak të mos caktimit të zyrtarit përgjegjës në një rast, shkeljes së afatit ligjor për caktimin e zyrtarit përgjegjës për rastet e sinjalizimit nga 23 institucione publike, mos njoftimit me shkrim së të punësuarve lidhur me të drejtat e parapara në LMS, si dhe mos njoftimit brenda afatit ligjor për këto të drejta nga ana e institucioneve publike, AKK duhet të iniciojë procedurat kundërvajtëse për institucionet publike si në tabelën 1 të këtij raporti.
- Mos miratimi i legjislacionit sekondar nga qeveria ka krijuar probleme për institucionet publike për zbatimin e LMS-së. Përkatësisht, në mungesë të këtij legjislacioni sekondar, institucionet publike nuk e kanë pasur të qartë periudhën kur duhet të caktohet zyrtari përgjegjës për rastet e sinjalizimit, mandatin e zyrtarit përgjegjës e çështje të tjera. Po ashtu, kjo mungesë e legjislacionit sekondar ka ndikuar edhe në laramaninë e formës se si institucionet publike kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për rastet e sinjalizimit. Përkatësisht, disa institucione zyrtarin përgjegjës për rastete e sinjalizimit e kanë caktuar me vendim, disa të tjera me njoftim përmes postës elektronike etj.
- Sipas përgjigjeve që IKD ka pranuar, AKK dy (2) institucioneve publike nuk u kishte dërguar me kohë kërkesë për caktim të zyrtarit përgjegjës për rastet e sinjalizimit.
- Nga të gjitha institucionet që kanë kthyer përgjigje, 51 prej tyre u kanë siguruar të punësuarve udhëzime me shkrim lidhur me procedurat e sinjalizimit. Ndërsa, 17 institucione të tjera nuk e kishin respektuar formën e dhënies së udhëzimeve për të punësuarit, në atë mënyrë që tetë (8) institucione publike kanë deklaruar se udhëzimet i kanë dhënë gojarisht, derisa nëntë (9) të tjera këtë obligim ligjor “e kanë përmbushur” me anë të publikimit të Udhëzuesit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në faqet e tyre zyrtare.
- Të paktën gjashtë (6) institucione publike, njoftimin me shkrim për të punësuarit lidhur me procedurat e sinjalizimit e kishin bërë vetëm pasi IKD kishte dërguar kërkesë për informata dhe qasje në dokumente publike në institucionet respektive.
- Sipas përgjigjeve që IKD ka pranuar, del se nga hyrja në fuqi e LMS-së, është paraqitur vetëm një rast i sinjalizimit të brendshëm. Ndërsa, sipas AKK-së, krahas këtij rasti, është edhe një rast tjetër i sinjalizimit të brendshëm i paraqitur brenda institucioneve publike.
- Sipas AKK-së, deri më tani kjo Agjenci ka pranuar gjithsej pesë (5) sinjalizime të jashtme, të cilat i ka trajtuar sipas ligjit.

- Akademia e Drejtësisë e ka cilësuar zyrtarin përgjegjës për konflikt të interesit si zyrtar për rastet e sinjalizuesve, për të cilën arsye, ka thënë se zyrtarin për rastet e sinjalizuesve e ka caktuar para se LMS të hyjë në fuqi.
- Në vendimin e MSh-së për caktimin e zyrtarit përgjegjës për rastet e sinjalizimit ka një amulli në kuptim të datës së nxjerrjes së këtij vendimi, arsyetimit dhe vulës së protokollit të këtij vendimi.
- Në një rast, një institucion publik zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit, në mungesë të njohurive mbi LMS-në, e kishte mbajtur të fshehur për punëtorët e tjerë, përkatësisht për personat që potencialisht mund të paraqiten si sinjalizues. Arsyetimi për këtë veprim kishte qenë qëllimi i institucionit publik që zyrtari përgjegjës për rastet e sinjalizimit “*të jetë i suksesshëm në punë*”.
- Në dy (2) përgjigje të pranuar nga IKD, institucionet publike zyrtarit përgjegjës për rastet e sinjalizimit i referohen si “*sinjalizues*”.

10. Rekomandimet

1. MD urgjentisht ta hartojë dhe ta dërgojë për miratim në Qeveri legjislacionin sekondar për fushën e sinjalizimit.
2. MD së bashku me AKK të hartojnë një strategji konkrete për ti informuar dhe trajnuar mbi LMS-në të gjitha institucionet publike, veçanërisht zyrtarët përgjegjës për rastet e sinjalizimit.
3. Institucionet publike ta zbatojnë Ligjin për Qasje në Dokumente Publike duke dhënë qasje në informatat dhe dokumentet publike. Po ashtu, shtatë (7) komunat me shumicë serbe në Kosovë, të publikojnë kontaktet në faqet e tyre zyrtare.
4. Si në rastin e LMS-së por edhe në rastet e tjera, institucionet publike të zbatojnë obligimet e tyre ligjore, duke respektuar afatet ligjore.
5. Komuna e Shtërpcës të caktojë zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit.
6. Të gjitha institucionet publike të njoftojnë “*me shkrim*” të punësuarit lidhur me procedurat e sinjalizimit.
7. AKK të iniciojë procedurat kundërvajtëse ndaj institucioneve publike që nuk kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për rastet e sinjalizimit.
8. AKK të iniciojë procedurat kundërvajtëse ndaj institucioneve publike që nuk kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për rastet e sinjalizimit brenda afatit ligjor.
9. AKK të iniciojë procedurat kundërvajtëse ndaj institucioneve publike të cilat nuk kanë njoftuar me shkrim të punësuarit lidhur me procedurat e sinjalizimit.
10. AKK të iniciojë procedurat kundërvajtëse ndaj institucioneve publike të cilat nuk kanë njoftuar me shkrim të punësuarit lidhur me procedurat e sinjalizimit brenda afatit ligjor.
11. AKK të mbajë evidenca të sakta lidhur përmbushjen dhe mos përmbushjen e obligimeve ligjore sipas LMS-së. Me qëllim të sigurimit të informatave të nevojshme, AKK ta shfrytëzojë mundësinë për bashkëpunim ndër-institucional.
12. Institucionet publike caktimin e zyrtarëve përgjegjës për rastet e sinjalizimit ta bëjnë me vendim.
13. AKK në rastet e tjera, të sigurohet që njoftimet e saj të shkojnë tek të gjitha institucionet që bartin obligime sipas ligjit.
14. Akademia e Drejtësisë të qartësojë situatën e zyrtarit përgjegjës për rastet e sinjalizimit, që i njëjti zyrtar të jetë i përcaktuar sipas dispozitave të LMS-së.
15. AKK të hetojë vendimin e MSh-së për caktimin e zyrtarit përgjegjës për rastet e sinjalizimit në mënyrë që të qartësojë kontradiktat e këtij vendimi.
16. KMDM t'i njoftojë punëtorët e saj me zyrtarin përgjegjës për rastet e sinjalizimit.
17. Institucionet publike ta bëjnë të qartë dallimin në mes të zyrtarit përgjegjës për rastet e sinjalizimit dhe sinjalizuesit.